

POLITIKA E ANTI-KORRUPSIONIT

Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, si një agjenci mbikëqyrëse policore, dhe strukture anti-korrupsion gjatë periudhës **Prill 2013 - Mars 2014**, ka arritur rezultatet e mëposhtme në fushën e parandalimit, zbulimit, dokumentimit dhe goditjes së veprimtarisë së jashtëligjshme e korruptive nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit.

Reforma ligjore

Hartimi i një ligji të ri për SHKB-në, mbi bazën e konceptit të mbikëqyrjes qytetare, i cili ka për qëllim:

- Përqasjen “reaktive” që mundësohet nga trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave të qytetarëve ndaj punonjësve të policisë për sjellje joetike, abuzim me detyrën, kryerje të veprimtarisë korruptive etj.
- Përqasjen “proaktive”, nëpërmjet grumbullimit dhe analizimit të informacionit kriminal, inspektimit, operimit dhe organizimit policor si dhe vlerësimit të nivelit të përputhshmërisë me ligjin dhe procedurat.

Aktualisht draft – ligji, i hartuar nga grupi i punës me ekspertë të fushës, si dhe me asistencën e ICITAP dhe PAMECA IV është përfunduar dhe është dërguar për procedurë në Këshillin e Ministrave.

Veprimtaria hetimore e strukturave të SHKB-së, e pasqyruar në numrin e kallëzimeve penale të dërguara pranë organit të Prokurorisë gjendet si më poshtë:

Viti	Lloji i veprës penale	Nr. çështjeve penale	Nr. subjekteve	Nivelet						Arrestuar/ Punonjës policie/shtetas	
				I lartë	Mesëm drejtues	Parë drejtues	Zbatues	Punonjës civile	Shtetas		
Prill 2013 - Mars 2014	Vepra korruptive	90	128	1	3	49	58	17	6	18	4
	Veprime arbitrare	26	39	-	-	11	28	-	-		-
	Vepra të tjera	28	26	-	-	11	15	-	2	3	-
	Totali	144	193	1	3	71	101	17	8	21	4

Administrimi, trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave të shtetasve

Për periudhën Prill 2013 – Mars 2014, nga strukturat e hetimit të SHKB-së janë administruar, trajtuar dhe shqyrtuar 317 ankesa nga shtetas për punonjës policie, ku:

- në 40 raste është sugjeruar fillimi i ecurisë disiplinore për 40 punonjës policie.
- në 5 raste është filluar hetimi penal për 8 punonjës policie.

Veprimtaria inspektuese e strukturave të SHKB-së.

Gjatë periudhës analizuese nga strukturat e Drejtorisë së Inspektimeve të SHKB-së janë kryer inspektime të zakonshme të përcaktuar në kalendarin vjetor të punës, por edhe inspektime jashtë rradhe. Fusha e objektit të inspektimeve të kryera ka përfshirë pothuasje të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit. Raportet me konstatimet dhe rekomandimet e dhëna janë dërguar pranë strukturave përkatëse të policisë, ku është kryer inspektimi. Konkretisht, për periudhën **Prill 2013 – Mars 2014** janë kryer 13 inspektime të zakonshme, si më poshtë:

- 4 inspektime në Drejtoritë e Policive në Qarqe;
- 2 inspektime në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit;
- 3 inspektime në Komisaritet e Menaxhimit të Trafikut Interurban;
- 4 inspektime në Organet Administrative Shtetërore për Shqyrtimin e Kundravajtjeve Administrative.

Bazuar në materialin e përftuar nga inspektimi në strukturat e organeve administrative shtetërore, SHKB-ja ka dërguar pranë Prokurorisë, materialin kallëzues për 4 punonjës të nivelit të parë drejtues dhe 1 punonjës i nivelit zbatues. Këta persona janë të dyshuar për "Shpërdorim detyre" dhe "Korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", parashikuar nga nenet 248 e 259 të Kodit Penal. Çështja është në hetim.

Për të njëjtën periudhë janë kryer 19 Inspektime jashtë rradhe, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit, Qendrën e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit dhe në disa Drejtori të Policisë në Qarqe.

Strukturat e Drejtorisë së Standardeve Profesionale të Policisë së Shtetit, bazuar në konstatimet/gjetjet e grupit të inspektimit, kanë filluar ecurinë disiplinore për 42 punonjës policie, nga të cilët 17 për “shkelje të rëndë të disiplinës” dhe 15 për “shkelje të lehtë të disiplinës”.

Gjithashtu, SHKB-ja ka referuar në prokurori si material kallëzues ndaj 22 punonjësve të policisë, konstatimet/gjetjet e grupit të inspektimit, për veprat penale të “shpërdorim të detyrës” apo “vjedhjes duke shpërdoruar detyrën”. Prokuroria ka regjistruar procedimet penale, të cilat janë në hetim.

Raport-inspektimet janë shoqëruar me problematikat e evidentuara sipas tematikave të përcaktuara dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësim.

KONTROLI I KUFIJVE DHE POLITIKA E VIZAVE

- a) Hyrje.

Aktualisht, Policia e Kufirit dhe Migracionit, është qartësisht e strukturuar brenda Policisë së Shtetit, me burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike. Procedurat Standarde të Punës, janë një realitet dhe përbëjnë një tregues të qartë të standardizimit të punës së kësaj strukture me ato të standardeve Schengen.

Baza ligjore e PKM është e plotë në drejtim të kufijve të jashtëm. Ekziston një Strategji Kombëtare Ndërsektoriale për MIK dhe Plani i saj i Veprimit, 2014-2020. Gjithashtu është përafruar baza ligjore me legjislacionin e BE-së dhe Procedurat e Punës së PKM janë përshtatur sipas Katalogut Schengen. PKM është e pajisur me infrastrukturë dhe pajisje moderne të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror.

Strukturat e Policisë Kufitare kanë rritur më tej cilësinë e veprimeve për kontrollin kufitar, si dhe kanë arritur rezultate në parandalimin dhe luftën ndaj krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të lëndëve narkotike, kontrabandës së mallrave të ndryshme, parandalimit të kalimeve të paligjshme të kufirit.

b) Në kuadrin e përmirësimit të legjislacionit:

- Ligji i ri, Nr. 108/2013 “Për të huajt”, është miratuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 513, datë 13.06.2013 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, është përgatitur dhe miratuar.
- Marrëveshjet “Për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar në Pikat e Kalimit Kufitar Morinë - Vermicë, Qafë Morinë, Qafë Prush” dhe marrëveshjet “Për hapjen e pikave të përbashkëta të kalimit ndërkufitar Shishtavec-Krushevë, Borje - Gllaboçicë, Orgjost-Orçush” dhe marrëveshjet “Për ngritjen e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor në Morinë - Vermicë”, janë miratuar.
- Në kuadër të implementimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri / Komuniteti Evropian, është nënshkruar Protokolli i Ripranimit me Francën (shkurt 2013).
- Është nënshkruar Marrëveshja e Ripranimit dhe Protokolli i Zbatimit me Moldavinë.
- Është nënshkruar marrëveshje me Austrinë më datë 29 janar 2013 dhe memorandum Mirëkuptimi me Britaninë e Madhe më 13 mars 2013, Tiranë, lidhur me shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave për çështjet e kontrollit të migracionit dhe azilit.

“Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Plani i saj i Veprimit për periudhën 2014-2020”, u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 119, datë 05.03.2014.

Strategjia synon:

- Konsolidimin e bashkëpunimit ndërmjet të gjitha agjencive të përfshira në sigurinë e kufirit dhe lehtësimin e tregtisë.

- Zhvillimin e politikave të duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë kufitare, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe standardeve të menaxhimit burimeve njerëzore dhe teknike;
- rritjen e kapaciteteve operacionale në goditjen e krimit ndërkufitar bazuar në vlerësimin e kërcënimeve;
- rritjen e bashkëpunimit me strukturat e brendshme dhe partnerët fqinjë dhe të BE-së;
- ndjekjen dhe dënimin e çështjeve të korrupsionit në të gjitha nivelet dhe sidomos ato të profilit të zyrtarëve të lartë;
- rritjen e kapaciteteve investiguese dhe orientimit të këtyre strukturave drejt inteligjencës;
- rritjen e menaxhimit të përpunimit të informacionit kriminal (MEMEX);
- përmirësimin e kapaciteteve për aplikimin e teknologjive të reja në fushën e menaxhimit të kufijve dhe aplikimi i masave kompensuese me qëllim kontrollin e territorit në lidhje me imigracionin e paligjshëm.

Janë përgatitur dhe janë në proces miratimi:

- Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8663, datë 18.09.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT”.
- Protokolli i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për Pikën e Përbashkët të Kalimit Kufitar Grabon-Zatrijebacka Cijena.
- Protokolli i zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për Qendrën e Përbashkët të Bashkëpunimit Policor Muriqan.
- Projekt Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Qeverisë së Republikës së Italisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Mbi punën e qendrës së përbashkët të bashkëpunimit policor, Sarandë”.

c) Zhvillimet në kuadrin operacional dhe institucional:

- Janë përmirësuar Procedurat Standarde të Punës në aspektin e procedurave të refuzimit të hyrjes. Është përgatitur formulari i refuzimit të hyrjes në përputhje me formularin e zonës Schengen.
- Janë përmirësuar Procedurat Standarde të Punës në lidhje me intervistimet në kontroll të vijës së parë dhe të dytë, me qëllim evidentimin dhe parandalimin e rasteve të azilkërkuesve të mundshëm në BE/Schengen dhe të personave që mund të abuzojnë me kushtet e qëndrimit në Schengen.
- Janë përmirësuar Procedurat Standarde të Punës në lidhje me kalimin në kufi të të miturve.
- Ka hyrë në përdorim të plotë moduli E-Leje Qëndrimi, i cili mundëson regjistrimin On-Line të aplikimeve për leje qëndrimi nga tetë Drejtoritë Rajonale të Kufirit & Migracionit.
- Janë kompletuar të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar me kompjutera të rinj dhe me vula të reja të hyrje-daljes në kufi.

d) Trajnime

Gjatë vitit 2013:

Strukturat e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin (në nivel qendror dhe atë lokal), si dhe në bashkëpunim me misionet e huaja të atashuara në Shqipëri, si ICITAP, US EXBS, Misioni PAMECA IV, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Fondacionin Hanss Seidel, Misionet e UNHCR, UNODC si dhe disa Ambasada të huaja të atashuara në Shqipëri, si Ambasada Amerikane dhe Ambasada Kanadeze, kanë zhvilluar gjithsej 83 trajnime, ku janë trajnuar 1232 punonjës policie.

Gjatë tremujorit të parë 2014 janë zhvilluar 18 trajnime, në të cilat janë trajnuar 184 punonjës.

e) Përmirësimi i analizës së riskut

Policia Kufitare dhe Migracionit kryen analizën e riskut (e cila përbëhet nga vlerësimi i kërcënimit dhe vlerësimi i riskut) në nivel qendror, rajonal dhe lokal, mbi bazën e të dhënave mbi migracionin. Këto të dhëna sigurohen përmes mekanizmit ekzistues të menaxhimit të të dhënave mbi migracionin, në përputhje të plotë me modelet dhe metodologjinë që përdor FRONTEX-i.

Materialet analitike të përgatitura në nivel qendror, rajonal dhe lokal, dërgohen në të gjitha PKK, për njohjen e punonjësve të policisë kufitare dhe migracionit me modus operandin e përdorur, në lidhje me imigracionin ilegal, përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, lëndëve narkotike, kontrabandës, mjetet e vjedhura dhe të gjithë informacionin tjetër në interes të analizës së riskut.

Materialet analitike

- a) Analiza ad hoc, krahasuese mujore, lidhur me fenomenin e shtetasve të huaj të kapur duke hyrë ose duke qëndruar në mënyrë ilegale në territor. Kjo analizë mbështetet në të dhënat mujore që kjo zyrë raporton në FRONTEX në kuadrin e rrjetit WBRAN.
- b) Janë shpërndarë në të gjitha PKK, 122 ALERTE, mbi dokumentet e falsifikuara të kapura në PKK. Gjithashtu, sipas udhëzimeve të PCC SEE disa prej alerteve i janë dërguar edhe pikave të kontaktit në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë.
- c) Analiza risku mbi shtetasit shqiptarë të kthyer nga vendet e BE/Schengen.
- d) Analiza Risku dhe Profile Risku mbi fenomenin e flukseve migratore ilegale, të cilat kalojnë nëpër Shqipëri, si dhe fenomenin e trafikimit të lëndëve narkotike.

Materialet analitike, Janar 2013 – Mars 2014:

- 207 materiale analitike për imigracionin e paligjshëm.
- 198 materiale analitike për trafikimin e drogën.

- 122 materiale analitike dokumentet e falsifikuara.
- 12 materiale analitike për trafikimin e armëve.
- 23 materiale analitike për kontrabandë.
- 25 materiale analitike për automjetet e vjedhura.
- 6 materiale analitike për vlerat monetare.
- Analiza vjetore e riskut për kufirin në Shqipëri, për vitin 2013.

f) Menaxhimi i informacionit të analizës së riskut dhe inteligjencës për planifikimin e shërbimeve në plan rajonal dhe lokal.

Në kuadrin e zbatimit të protokolleve për patrullimin e përbashkët me vendet fqinje janë zhvilluar:

Gjatë vitit 2013:

- 236 patrullime të përbashkëta me Malin e Zi,
- 106 patrullime të përbashkëta me Maqedoninë (81 Korça dhe 25 Dibra),
- 205 patrullime të përbashkëta me Kosovën,
- 13 operacione të sinkronizuara në kufirin me Greqinë.

Gjatë 3 mujorit të parë të 2014:

- 51 patrullime të përbashkëta me Malin e Zi,
- 22 patrullime të përbashkëta me Maqedoninë,
- 59 patrullime të përbashkëta me Kosovën dhe 2 operacione në kufirin me Greqinë.

Konstatohen rezultate pozitive nga patrullimet dhe operacionet e përbashkëta në goditjen e krimit ndërkufitar, veçanërisht në trafikun e drogës, trafikut të mjeteve motorike, dokumenteve false dhe kontrabandës së mallrave. Në këtë kuadër janë shkëmbyer në kohë reale informacione midis shërbimeve operacionale të Komisarariatit të Policisë Kufitare Sarandë me policinë greke të Igumenicës dhe rojën bregdetare të Korfuzit dhe Igumenicës.

Pjesëmarrja në Operacionet e Përbashkëta nga deti, ajri dhe toka të organizuara nga FRONTEX, si vëzhgues, gjatë vitit 2013.

1. Nga ajri - "Flexi Force 2013" - Moduli Operacional Mizar – Aeroporti i Brukselit.
2. Nga toka - "Focal Points 2013" - PKK Gruskovje, Slloveni.
3. Nga ajri - "Flexi Force 2013" - Moduli Operacional Mizar 2 – Aeroporti i Bergamos, Itali.
4. Nga toka - "Neptune 2013" - Kufiri tokësor Hungari - Serbi dhe Kroaci - Serbi.
5. Nga deti - "JO EPN Aeneas 2013" - ICC (Qendra Ndërkombëtare e Koordinimit) Romë, Itali.
6. Nga toka - Dy ekspertë të BE-së u vendosën në Muriqan në kuadër të Operacionit të Përbashkët "Focal Points Land 2013" (Coordination Points Project 2013).

7. Nga deti - "Poseidon Sea 2013" - ICC (Qendra Ndërkombëtare e Koordinimit) Pireaus dhe LCC (Qendra Lokale e Koordinimit) Lesvos.
8. Nga ajri - Një oficer i policisë kufitare Italiane u vendos në aeroportin e Rinasit (TIA) në kuadër të Operacionit të Përbashkët "Focal Points Air 2013".
9. Nga ajri - "Focal Points Air 2013" - Fiumicino Romë, Itali.

Gjithashtu, gjatë vitit 2014, do të vazhdojë pjesëmarrja e Policisë Kufitare dhe Migracionit në Operacionet e Përbashkëta nga toka, ajri dhe deti.

- Në Operacionin e Përbashkët "Focal Points 2014 Air", janë planifikuar të marrin pjesë dy punonjës të Komisarariatit të Policisë Kufitare të Aeroportit "Nënë Tereza", Rinas, të cilët do të vendosen në Aeroportet Ndërkombëtare të Romës dhe Brukselit. Gjithashtu, një ekspert i BE, do të vendoset pranë Aeroportit "Nënë Tereza", Rinas, për një periudhë 17-18 ditë, gjatë muajit Maj 2014.
- Është planifikuar pjesëmarrja në Operacionet e Përbashkëta nga toka "Focal Points Land 2014" dhe "Flexible Operational Activities 2014", që do të zhvillohen në kufirin tokësor Kroaci-Mali i Zi, Hungari-Serbi dhe Kroaci- Serbi në periudhat 28 Maj - 25 Qershor 2014 dhe 2 - 30 Korrik 2014. Në këtë operacion janë planifikuar të marrin pjesë katër punonjës të policisë kufitare dhe migracionit dhe ekspertë të huaj nga vendet e BE.

Operacione në kuadër të bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor, organizuar nga DCAF:

Gjatë vitit 2013

- 2 operacione të përbashkëta, në të cilat janë shkëmbyer punonjës nga vende të ndryshme për të operuar në PKK dhe në Stacionet e kufirit të gjelbër.
- 2 operacione të koordinuara, në PKK të ndryshme të vendeve respektive, ku shkëmbehen të dhënat dhe informacionet kryesisht për dokumentet, mjetet dhe veprimtaritë e paligjshme të evidentuara.

Gjatë vitit 2014 janë planifikuar 2 operacione të përbashkëta dhe 2 të koordinuara, të cilat do zhvillohen pas tremujorit të parë.

g) Në parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar:

Gjatë vitit 2013

- Gjithsej janë evidentuar 501 vepra penale, nga të cilat 434 janë zbuluar, ose 87%, me 516 autorë, nga të cilët 199 janë arrestuar, 9 janë ndaluar, 298 janë ndjekur në gjendje të lirë dhe 18 janë shpallur në kërkim.
- Janë evidentuar 366 vepra penale, objekt i punës së sektorit të Hetimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, nga të cilët janë zbuluar 311 vepra penale, ose 94%, me 363 autorë, nga të cilët 76 të arrestuar, 275 janë ndjekur në gjendje të lirë dhe 7 janë larguar dhe janë shpallur në kërkim.
- Janë evidentuar 165 vepra penale të tjera, që nuk janë objekt i punës së sektorit të Hetimit të Policisë Kufitare dhe Migracionit, nga të cilët janë zbuluar 123 vepra

penale, ose 75%, me 153 autorë, nga të cilët 123 të arrestuar, 23 janë ndjekur në gjendje të lirë dhe 11 janë shpallur në kërkim.

- Gjithsej janë kapur 497 persona në kërkim, (nga këta 415 në kërkim kombëtar, 29 në kërkim ndërkombëtar dhe 53 persona në kërkim për llogari të Policisë së Kosovës).
- Gjithsej janë vënë 5494 gjoba për “Kalim të paligjshëm të kufirit”.
- Trafikimi i lëndëve narkotike – nga Policia Kufitare dhe Migracionit janë evidentuar 118 raste të trafikimit të lëndëve narkotike. Sasia e kapur është e konsiderueshme dhe arrin në një total prej 10.447 kg *Cannabis Sativa*, 36.3 kg heroinë, 13.6 kg kokainë.

Tremujori i parë 2014

- Janë evidentuar 172 vepra penale, nga të cilat 145 të zbuluara, me 195 autorë, nga të cilët 84 arrestuar, 4 ndaluar, 101 gjendje të lirë, 2 larguar dhe 4 persona shpallur në kërkim.
- Për veprat penale që janë objekt pune i Sektorit të Hetimit të Policisë Kufitare janë evidentuar 108 vepra, 105 zbuluar, me 129 autorë, nga të cilët 29 janë arrestuar, 4 ndaluar, 95 në gjendje të lirë dhe 3 janë shpallur në kërkim.
- Vepra penale të tjera që nuk janë objekt pune i Sektorit të Hetimit të Policisë Kufitare janë evidentuar 64 vepra dhe 40 zbuluar, me 66 autorë, ku 55 janë arrestuar, 8 janë në gjendje të lirë dhe 2 shpallur në kërkim.
- Trafikimi i lëndëve narkotike: nga PKM janë kapur 2791,3 kg cannabis sativa, 13.878 kg heroin dhe 111gr. kokainë, 859 gr përzierës, si dhe janë asgjësuar 150 rrënjë bimë cannabis sativa.

h) Funksionimi i QNOD

Është rritur bashkëpunimi dhe koordinimi i institucioneve të përfshira në menaxhimin e kufirit blu nëpërmjet forcimit të analizës riskut dhe informacionit kriminal në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (IMOC-QNOD). Në muajin gusht të vitit 2013 është lidhur sistemi MEMEX në QNOD. Gjithashtu, janë në funksion operacional Sistemi SIVHD (sistemi i radari), sistemi i komunikimit me radio “TETRA”. Sistemi “Blu Box”, ka momentalisht probleme në funksionim për shkak të ndërrimit të varësisë së institucionit përgjegjës dhe ndarjes së përgjegjësisë mes institucioneve të përfshira në QNOD.

Gjatë vitit 2013

Janë bërë 92 verifikime për kontrollin në hapësirës detare, 50 operacione kërkimi në bashkëpunim edhe me Rojën Bregdetare dhe 14 operacione për goditjen e trafikut të lëndëve narkotike në hapësirën detare. Në këto verifikime janë sekuestruar 7 mjete lundruese, me një sasi mbi 5 ton kanabis sativa.

Tremujori i parë i vitit 2014

Nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare janë bërë 29 verifikime për kontrollin e hapësirës detare, 5 operacione kërkim-shpëtimi dhe 10 operacione për goditjen e trafikut të lëndëve narkotike, ku janë sekuestruar 7 mjete lundruese dhe 3 raste të trafikut të lëndëve narkotike, me një sasi prej 2,946 kg kanabis sativa.

i) Monitorimi i lëvizjes pa viza

Monitorimi i lëvizjes pa viza i shtetasve shqiptarë në drejtim të vendeve BE/Schengen, është një nga mekanizmat kryesorë, mbi të cilin mbështetet Policia Kufitare dhe Migracionit, për të reduktuar fenomenet negative, që lidhen me të dhe sidomos ato të azil kërimit dhe tejkalimit të afatit të qëndrimit në këtë hapësirë.

Gjatë kësaj periudhe autoritetet policore kufitare dhe të migracionit kanë monitoruar çdo muaj procesin e liberalizimit të vizave.

- a. Ka vazhduar shpërndarja e fletëpalosjeve informative për regjimin e lëvizjes pas liberalizimit të vizave;
- b. Janë intervistuar shtetasit që lëvizin për herë të parë ose mbështetur në profilizimin e personit që do të udhëtojë.
- c. Në Pikat e Kalimit Kufitar, punonjësit e policisë kufitare janë udhëzuar të përdorin teknika intervistimi për të identifikuar azilkërkues të mundshëm që në momentin e nisjes nga Shqipëria.

Gjatë vitit 2013, kanë udhëtuar nga Shqipëria në drejtim të vendeve BE/Schengen 2,140,150 shtetas.

Nga monitorimi rezulton se gjatë periudhës 01.01.2013 – 31.12.2013, nga autoritetet policore të vendeve Schengen/BE, i është refuzuar hyrja në këto vende 11,946 shtetasve shqiptarë, ose 0.04%. Për 3800 shtetas arsyeja e refuzimit ka qenë “Informacioni në Sistemin e Schengen (SIS)”; Për 5818 shtetas arsyeja e refuzimit ka qenë “Mungesë e mjeteve financiare”; dhe 2328 shtetasve u është refuzuar “Për arsye të tjera”, ku 63% e totalit të shtetasve u është refuzuar hyrja në Greqi, dhe 37% në vendet e tjera të zonës Schengen.

Në zbatim të procedurave standarde dhe në kuadër të monitorimit të liberalizimit të vizave dhe abuzimit me kërkesat për azil, gjatë vitit 2013, nga Policia Kufitare dhe Migracionit në PKK, janë bërë 7308 refuzime në dalje të shtetasve shqiptar me arsyet e mëposhtme:

- a) 1811 refuzim dalje për mos justifikimin të qëllimit të udhëtimit;
- b) 1400 refuzim dalje për arsyen e mungesës së dokumentacionit;
- c) 153 refuzim dalje për arsyen e mungesës së mjeteve financiare;
- d) 3315 refuzim dalje për arsyen se këta shtetas kanë qenë më parë të larguar nga vendet BE/Schengen dhe kanë ndalim hyrje në këtë territor;
- e) 377 refuzim dalje për arsyen së kjo kategori shtetasish kanë konsumuar ditët e qëndrimit në hapësirën BE/Schengen;
- f) 252 refuzim dalje për arsye të tjera.

Gjithashtu, lidhur me masat e marra nga Policia Kufitare dhe Migracionit për evidentimin e shtetasve shqiptarë, të cilët kërkojnë të ndërrojnë gjeneralitetet për të evituar refuzimin e hyrjes në vendet Schengen si pasojë e urdhrave për ndalim hyrje në këtë hapësirë, rezulton së gjatë vitit 2013 janë bërë 2870 kërkesa për ndërrimin e gjeneraliteteve, ku 2141 shtetas kanë rezultuar të rregullt, ndërsa 734 ose 25% e shtetasve që kanë kërkuar të ndërrojnë gjeneralitetet kanë rezultuar të kthyer deportivë, Inad ose me të dyja masat së bashku.

Për tremujorin e parë të vitit 2014

- Është refuzuar hyrja për 2,883 shtetas shqiptarë nga ana e autoriteteve të policive kufitare të vendeve të BE-së. Nga këta, 1379 shtetas janë refuzuar për mungesë të mjeteve financiare, 659 shtetas për informacione në SIS dhe 845 shtetas për arsye të tjera.
- Numri i kthimeve/deportimeve nga vendet BE/Schengen në total është 3,534.
- Është refuzuar dalja e 2877 shtetasve shqiptarë.
- Kërkesat për ndërrim gjeneralitetesh janë gjithsej 72, nga të cilat 40 janë të rregullta.

Azili dhe Migrimi, përfshirë Ripranimin

Hartimi i Ligjit të ri "Për azilin", i cili është përpunuar duke marrë në konsideratë mendimet e strukturave të interesuara, me qëllim përshtatjen e plotë me direktivat e BE-së, është në proces.

Në prill 2014 janë shpërndarë specimenet e ID card dhe Travel document për të huajt (të huajt që kanë fituar statusin e refugjatit) së bashku me manualët shpjeguese për elementet e sigurisë.

Aktualisht, jemi në fazën e verifikimeve të shtetasve që kanë përfituar statusin dhe po ndiqen procedurat për pajisjen me dokumente identifikimi.

Nga muaji maj 2013, kemi marrë 4 vendime për njohje të statusit të refugjatit dhe kemi 3 pushime statusi (lënie të statusit me dëshirë, largim me dëshirë).

Në strukturën e Qendrës Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, (QKPA), janë përfshirë 3 kategori të reja punonjësish:

- a. Specialist përkthyes
- b. Psikolog
- c. Punonjës social

Të gjithë azilkërkuesit janë pajisur me librezë shëndetësore.

Migracioni

Për periudhën janar 2013 - mars 2014, në drejtim të menaxhimit të migracionit ka patur progres lidhur me:

Përmirësimin e normativës migratore

Janë miratuar dhe po implementohen:

- Ligji Nr. 108/2013 “Për të huajt”,
- VKM Nr. 513, datë 13.06.2013 “Mbi kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”,
- 17 Projekt VKM “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe të procedurave për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen e anulimin e lejes së punës”, sipas llojeve të lejeve të punës.

Janë përgatitur dhe janë në proces miratimi:

- Projekt VKM “Për miratimin e specifikimeve teknike dhe modeleve të dokumenteve të udhëtimit për të huajt”.
- Projekt VKM “Për miratimin e specifikimeve teknike dhe modelit të lejes së qëndrimit biometrike për të huajt”.
- Projekt VKM “Për miratimin e Profilit Kombëtar të Zgjeruar mbi Migracionin për vitin 2013”.
- Projekt Udhëzimi i Ministrit të Punëve të Brendshme, “Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj të cilët nuk plotësojnë, ose nuk plotësojnë më tej kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
- Projekt Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror “Mbi bashkëpunimin mes strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me leje qëndrimi”.
- Projekt Udhëzim i Përbashkët i Ministrit të Punëve të Brendshme, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror “Mbi bashkëpunimin ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror për procedurat e lëshimit të vizave për të huajt”.

Në fushën e ripranimeve dhe luftës kundër migracionit të paligjshëm:

- Është nënshkruar Marrëveshje me Austrinë më datë 29 janar 2013 dhe Memorandum Mirëkuptimi me Britaninë e Madhe më 13 mars 2013, Tiranë, lidhur me shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave për çështjet e kontrollit të migracionit dhe azilit.
- Në kuadrin e riintegritimit dhe trajtimit social të miturve të pashoqëruar që kthehen nga vendet e tjera është nënshkruar Urdhri i Përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror, Nr. 332/3, datë 07.03.2014.
- Në kuadër të implementimit të Marrëveshjes së Ripranimit Shqipëri / Komuniteti Evropian, është nënshkruar Protokolli i Ripranimit me Francën, më 8 shkurt 2013, në Tiranë.
- Është nënshkruar Marrëveshja e Ripranimit dhe Protokolli i Zbatimit me Moldavinë, në Bukuresht, më 18 tetor 2013.
- Është negociuar dhe është gati për nënshkrim Marrëveshja e Ripranimit dhe Protokolli i saj i zbatimit me Federatën Ruse.

Përmirësimi i Teknologjisë së Informacionit

- Që nga muaji Qershor 2013 dhe në vazhdim është vënë në funksionim Moduli E-leje qëndrimi;
- Është përgatitur dhe është në fazë testimi Moduli E-Trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në territor.

Menaxhimi i Imigracionit të rregullt

Gjatë vitit 2013 janë përpunuar 5621 aplikime për leje qëndrimi dhe në tremujorin e parë të vitit 2014 janë përpunuar 1261 aplikime.

Për vitin 2013, janë vlerësuar 3477 aplikime për vizë në ambasadat dhe konsullatat shqiptare jashtë shtetit, si dhe për periudhën Janar-Mars 2014, 2693 aplikime për vizë. Në procedurën e vlerësimeve të kërkesave për vizë iu është refuzuar kërkesa 353 shtetasve të huaj për vitin 2013 dhe 59 shtetas për tremujorin e parë të vitit 2014. Me kërkesë të MPJ janë lëshuar 178 viza në kufi për vitin 2013 dhe 25 viza në kufi për tremujorin e parë të vitit 2014. Policia Kufitare dhe Migracionit nuk ka lëshuar asnjë vizë në kufi me iniciativën e saj, për arsye humanitare apo diktuar nga fuqi madhore, për periudhën në fjalë.

Menaxhimi i Migracionit të Parregullt.

Emigracioni i parregullt. Ripranimet.

Mbështetur në Marrëveshjet e Ripranimit me Komunitetin Evropian dhe me shtete jo anëtare të BE-së, gjatë vitit 2013, janë kthyer/ripranuar në Shqipëri, 19,449 shtetas shqiptarë dhe 22 shtetas të vendeve të treta që kanë përdorur territorin shqiptar për të kaluar transit (Mali i Zi). Mbështetur në Marrëveshjet e Ripranimit me Komunitetin Evropian, gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, janë kthyer/ripranuar në Shqipëri nga vendet e BE-së, 4,032 shtetas shqiptarë. Nuk ka patur asnjë kërkesë për ripranim të shtetasve të vendeve të treta që kanë përdorur territorin shqiptar për të kaluar transit gjatë kësaj periudhe kohe.

Gjatë vitit 2013, 317 shtetasve të huaj iu është *refuzuar hyrja* (prapësuar në kufi) në territorin e Shqipërisë. Ndërsa, gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, iu është refuzuar hyrja 83 shtetasve të huaj.

Imigracioni i parregullt (largimet)

Gjatë vitit 2013 janë kapur me qëndrim të parregullt 1978 shtetas të huaj ose 44% më shumë se gjatë vitit 2012. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014 janë kapur 285 shtetas të huaj me qëndrim të parregullt, ose 25 % më pak se për të njëjtën periudhë të vitit 2013.

Shtetas të huaj të parregullt të kapur sipas kufijve me shtetet fqinjë rezultojnë së janë: 816 shtetas të kapur në kufi me Greqinë (duke hyrë në Shqipëri) dhe 127 shtetas që janë kapur në afërsi të kufirit me Malin e Zi (duke dalë nga Shqipëria). Pjesa tjetër janë kapur në brendësi të territorit.

Gjatë vitit 2013, nga totali i të huajve të kapur me qëndrim të parregullt (1978 raste), janë kthyer me urdhër dëbimi 331 shtetas në Greqi, 1 shtetas nga Kuba në Spanjë, 3 shtetas përkatësisht nga Eritrea, Siria dhe Polonia në Mal të Zi dhe 2 shtetas në Kosovë. Për 1,641 të tjerë janë nxjerrë urdhrat e largimit dhe është ndjekur largimi vullnetar i tyre.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2014, janë kthyer në Greqi me urdhër dëbimi 47 shtetas të vendeve të treta, ndërsa për 238 janë nxjerrë urdhrat e largimit vullnetar.

Aktivitetet për monitorimin e procesit të postliberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian

Task – Force për monitorimin e procesit të postliberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian, u krijua me Urdhrin e Kryeministrit Nr. 39, datë 5.2.2014, “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës, Task – Forcë, për monitorimin e procesit të postliberalizimit të vizave me Bashkimin Evropian”, si iniciativë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe ka në përbërje të saj përfaqësues të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Çështjet e Vendore. Më datë 25 shkurt 2014 u zhvillua takimi i parë i Grupit Ndërinstitucional të punës. Ky takim u kryesua nga Zëvendësministria e Punëve të Brendshme dhe përfaqësues të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Punëve të Jashtme, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si dhe përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Çështjet e Vendore.

Duke marrë shkas dhe nga zhvillimet e fundit të operacionit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për riatdhësimin e 48 personave nga Franca, si dhe të zhvillimeve të ngjashme në këtë fushë, u konsiderua e domosdoshme dhënia e një mesazhi të gjithë qytetarëve shqiptarë, të cilët dëshirojnë të udhëtojnë në zonën Schengen mbi respektimin e rregullave të qëndrimit. Zëvendësministria e Punëve të Brendshme theksoi faktin se ndërgjegjësimi i qytetarëve duhet të kryhet nëpërmjet mediave vizive dhe të shtypit, bashkëbisedim me studentët në Universitete etj, si dhe rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik për të drejtat dhe detyrimet e lëvizjes së lirë në zonën Schengen.

Një fenomen shumë i rëndësishëm, i cili ndikon në kërkesat për azil në vendet Schengen është dhe fenomeni i “Gjakmarrjes”, i cili u konsiderua si shumë i rëndësishëm për t’u diskutuar në vijim nga ky grup pune.

Gjithashtu, në muajin mars janë deportuar 47 shtetas shqiptarë, me qëndrim të parregullt në Britaninë e Madhe. Ata u dërguan drejt aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza” me një avion të posaçëm. Ministri i Shtetit në Britaninë e Madhe John Taylor, i

cili udhëtoi drejt vendin tonë, në një avion me të deportuarit, u prit në aeroport dhe pati një takim me Ministrin e Punëve të Brendshme. Përfaqësuesit e dy qeverive u bënë apel gjithë shtetasve shqiptarë, të mos ndërmarrin përpjekje për të kërkuar azil politik në Britani por edhe vende të tjera të BE-së.

Është përgatitur dhe spoti televiziv i cili po transmetohet nga media kombëtare, për ndërgjegjësimin e publikut për të mos shkelur rregullat e lëvizjes së lirë.

Bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Policia e Shtetit, në zbatim të objektivave dhe prioritetëve të saj strategjike në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, ka marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna në Raport Progresin e fundit të KE-së, për vitin 2013, si dhe vërejtjet dhe sugjerimet e bëra pas Takimit të Nënkomitetit BE-Shqipëri të zhvilluar në muajin Prill 2013. Pjesa më e madhe e këtyre rekomandimeve janë përfshirë edhe në Planin e Veprimit për implementimin e 5 prioritetëve (Roadmap 5), veçanërisht në Prioritetin Nr.4 “Lufta kundër Krimit të Organizuar”.

Reforma policore, përfshirë dhe bashkëpunimin policor

Që prej takimit të fundit të Nënkomitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë, në muajin Prill 2013, Policia e Shtetit përveç progresit të zhvilluar në luftën kundër krimit të organizuar dhe bashkëpunimit ndërkombëtar ka ndërmarrë një reformë të thellë, si në aspektin legjislativ, ashtu dhe aspektin strukturor.

Reformat kanë synuar rritjen e performancës së Policisë së Shtetit në të gjitha fushat, përmirësimin e kuadrit ligjor e institucional dhe rregullimin e disnivelit të krijuar në piramidën komanduese të Policisë. Kjo po sigurohet nëpërmjet reduktimit të numrit të lartë të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë dhe shtimit të numrit të punonjësve të policisë që punojnë në vijën e parë, pra në terren. Gjithashtu reformat kanë synuar rritjen e motivimit të punonjësve të policisë dhe forcimin e integritetit të tyre, që do të ndikojë në rritjen e besimit të publikut tek policia dhe në rritjen e treguesve dhe efikasitetit të hetimeve.

Në aspektin legjislativ, që prej Tetorit 2013, janë ngritur grupet e punës për të inicuar ndryshimet legjislative si më poshtë:

- a) Projektligjet “Për Policinë e Shtetit” dhe “Për gradat në Policinë e Shtetit”. Këto Projektligje janë menduar të shkrihen në projektligjin “Për Policinë e Shtetit”. Projektligji “Për Policinë e Shtetit” tashmë është në fazën përfundimtare.
 - b) Projektligji “Për shërbimin e sigurisë private”;
 - c) Projektligji “Për armët e zjarrit”;
 - d) Projektligji “Për përdorimin e armëve të zjarrit”;
- Për tre projektligjet e mësipërme ka përfunduar puna për hartimin dhe janë në proces miratimi.

Gjithashtu, përgatitja e Aktit “Mbi krijimin dhe organizimin e Akademisë së Policisë”, i cili do të bëjë të mundur përmirësimin e sistemit arsimor të Policisë së Shtetit dhe kualifikimin e oficerëve të ardhshëm të policisë, është në fazën përfundimtare.

Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr.93, datë 19.02.2014, “Mbi disa ndryshime në VKM Nr.1135, datë 05.08.2008” “Mbi pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit, i ndryshuar” është përmirësuar ndjeshëm niveli i pagesës së oficerëve të policisë duke rritur motivimin e tyre në luftën kundër krimit. Rritja e pagave të policisë në nivelin 30 % e më shumë, ka përmirësuar nivelin e pagave duke rritur më tepër pagat e punonjësve që punojnë në terren në krahasim me punonjësit administrativë.

Në aspektin strukturor, reforma ka shtuar numrin e punonjësve të policisë që punojnë në terren dhe ka reduktuar punonjësit e aparatit qëndror të Drejtorisë së Përgjithshme.

Tashmë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përbëhet nga 4 Departamente, Departamenti për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda, Departamenti i Sigurisë Publike, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse dhe disa drejtori në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm.

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e dhëna në raport progresin e KE-së dhe masat e planifikuara në Planin e Veprimit për Prioritetin 4 të Roadmap-it, është parashikuar që brenda gjashtëmuorit të parë të vitit 2014, të fuqizohen kapacitetet e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale me 30 punonjës policie, të rritet numri i punonjësve në strukturat kundër terrorizmit në DPQ si dhe tek Sektori për Korrupsionin dhe Krimin Ekonomik në qendër.

Gjithashtu është përgatitur struktura e re e njësisë kundër krimit kompjuterik, e cila në zbatim të rekomandimit të dhënë nga ekspertët e KE-së, nuk do të varet më nga Drejtoria për Krimet Ekonomike Financiare, por do të ketë varësi direkt nga Zv.Drejtori i Përgjithshëm i Policisë për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda.

Një risi që po përgatitet nga Ministria e Punëve të Brendshme, është krijimi dhe funksionimi i Byrosë së Hetimit. Grupi i punës i ngritur për këtë qëllim është duke përfunduar draftin final, pas konsultimeve të vazhdueshme me misionet PAMECA IV, ICITAP, disa oficerë ndërlidhës të vendeve të BE të atashuar në Tiranë dhe përfaqësues të Prokurorisë dhe institucioneve të tjera. Byroja është konceptuar si një strukturë brenda Policisë së Shtetit që do të hetojë në mënyrë të përqëndruar veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit në gjithë territorin e vendit, duke përdorur kapacitetet e analizës së informacionit kriminal, kapacitetet e saj operacionale dhe investigative.

Reforma në Policinë e Shtetit ka marrë në konsideratë dhe respektimin e barazisë gjinore dhe diversitetit, duke synuar në rritjen e numrit të femrave në polici. Gjatë muajve mars–prill 2014, gjatë procesit të rekrutimit të më shumë se 1000 kandidatëve të

rinj për në Shkollën e Policisë, është vendosur që 50 % e tyre të jenë femra dhe 2 % i numrit të përgjithshëm të kandidatëve të jenë nga zonat minoritare.

Bashkëpunimi policor ndërinstitucional dhe ndërkombëtar.

Bashkëpunimi policor ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit është mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues dhe marrëveshjet apo memorandumet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve. Theksi është vënë në rritjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit me Prokurorinë dhe veçanërisht Prokurorinë për Krimet e Rënda.

Në muajin dhjetor 2013, Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi që po zbatohet në nivel qendror ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror dhe në nivel vendor ndërmjet Drejtorive të Policisë në Qarqe, Prokurorive pranë Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe Degëve të Shërbimit Informativ të Shtetit në Qarqe.

Objekti i këtij Memorandumi është forcimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së tre institucioneve në parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar (trafiqeve të paligjshme), krimeve të rënda, korrupsionit dhe veprave penale që çenojnë regjimin juridik të tokës, mjedisit dhe burimeve natyrore.

Bashkëpunimi mes institucioneve ka bërë progres edhe në aktivitetin e 7 Njësive të Përbashkëta Hetimore për luftën kundër korrupsionit dhe krimit financiar, në përbërjen e të cilave janë dhe oficerët e policisë së shtetit.

Lidhur me rekomandimet e bëra për track rekordin dhe statistikave të harmonizuara, është ngritur dhe funksionon Grupi i Punës për Raportimin e Statistikave të Konsoliduara për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë grup pune marrin pjesë përfaqësues nga Policia e Shtetit, Prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë. Është parashikuar që të merren në konsideratë rekomandimet e dhëna në raportin e UNODC të financuar nga BE mbi raportimin statistikor në vendet e Ballkanit.

Bashkëpunimi policor Ndërkombëtar.

Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar ka qenë dhe mbetet një prioritet i Policisë së Shtetit dhe fokusohet kryesisht në shkëmbimin e shpejtë dhe cilësor të informacionit, në zbatimin e detyrimeve të marrëveshjeve, akteve ndërkombëtare dhe nismave rajonale në të cilat jemi pjesë. Koordinimi dhe shkëmbimi i vizitave ka synuar rritjen e kapaciteteve profesionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira me pjesëmarrje në seminare, workshope dhe kurse trajnimi.

Gjatë kësaj periudhe, rrjeti i Kryetarëve të ILECU, në kuadër të projektit ILECU, ka funksionuar si duhet. Pjesë e këtij rrjeti, ishte edhe përfundimi i Manualit të Bashkëpunimit Rajonal për zbatimin e ligjit në Evropën Juglindore.

Një prioritet mbetet rritja e bashkëpunimit me organet homologe të rajonit, SELEC dhe Europol, në mënyrë që të zhvillohen rezultatet analitike, vlerësimet e kërcënimit, shkëmbimi i informacionit si dhe kryerja e operacione të përbashkëta duke përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Gjatë periudhës janar 2013–mars 2014, janë nënshkruar dhe kanë hyrë në fuqi këto marrëveshje, protokolle dhe memorandume:

1. "Marrëveshje midis Këshillit të Ministrave të RSH dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit";
2. "Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Federale Austriake mbi shkëmbimin e ndërsjellë të të dhënave për çështjet e kontrollit të migracionit dhe për çështjet e azilit", nënshkruar në Vjenë, më datë 29 janar 2013.
3. V.K.M. Nr. 69, datë 23.01.2013, për miratimin e një amendamenti mbi Marrëveshjes së Mirëkuptimit në bashkëpunim me PCC SEE".
4. "Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar, Trebisht-Xhepisht", nënshkruar në Tiranë, më 23 mars 2013.
5. "Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë, për Programin e Policimit në Komunitet".
6. "Marrëveshja e ripranimit dhe Protokoli për implementimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Moldavisë për ripranimin e personave me qëndrim të paautorizuar.
7. Marrëveshja e Bashkëpunimit midis CEZ Shpërndarje Sh.A dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
8. Marrëveshja e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit "Për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit".
9. Marrëveshja e bashkëpunimit mes Policisë së Shtetit dhe Instituti Europian i Tiranës Komitetit "Për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit".
10. Memorandum Mirëkuptimi, Nr. 1220/5, datë 09.04.2013, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme që operon nëpërmjet Agjencisë së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin, nënshkruar në Tiranë më 13 mars 2013.
11. Protokoli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Franceze, nënshkruar në Tiranë në datë 08.04.2013, "Për zbatimin e Marrëveshjes ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Republikës së Shqipërisë, mbi ripranimin e personave me qëndrim të paligjshëm, nënshkruar më 14 prill 2005 në Luksemburg".

12. Marrëveshja dhe Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Ndërkufitar, Borje (Kukës) - Gllaboçice (Dragash), nënshkruar në muajin prill 2013. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që edhe në këtë PKK të aplikohet mënyra e punës si në PPKK Muriqan- Sukobin, miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
13. Marrëveshja dhe Protokolli ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për hapjen e Pikës së Përbashkët të Kalimit Kufitar, Orgjost (Kukës)-Orçush (Dragash), nënshkruar në muajin prill 2013. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është që edhe në këtë PKK të aplikohet mënyra e punës si në PPKK Muriqan -Sukobinë, miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.
14. Marrëveshja për ngritjen e Qendrës së Përbashkët të Bashkëpunimit Policor në Morinë-Vermicë me Kosovën. Kjo marrëveshje është në kuadër të zbatimit të kërkesave të Konventës së Vjenës, dhe ka të bëjë me krijimin e qendrave të përbashkëta të Bashkëpunimit Policor ndërmjet vendeve, me qëllim lehtësimin e rrugëve të shkëmbimit të informacionit, nënshkruar në muajin prill 2013.
15. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, mbi bashkëpunimin në fushën e kontrollit të brendshëm, nënshkruar në Pikën e Kalimit Kufitar Qafë Thanë, në 17 maj 2013.
16. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe and Këshillit të Ministrave të Bosnje Hercegovinës mbi menaxhimin e katastrofave, nënshkruar në Bruksel, më 14.05.2013.
17. Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Qendrës së Formimit Policor të Policisë së Shtetit dhe Kolegjit Policor European, CEPOL, në muajin maj 2013.
18. "Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunimin për organizimin e një Shërbimi të përbashkët të policimit rrugor të Policisë së Shtetit Shqiptar dhe Policisë së Kosovës, në territorin e Shqipërisë", nënshkruar në Tiranë, datë 17.05.2013.
19. Marrëveshja e Bashkëpunimit në fushën e sigurisë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, nënshkruar në Berlin, më 18.06.2013.
20. Marrëveshja mbi bashkëpunimin operacional dhe strategjik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), e cila është nënshkruar më 9 dhjetor 2013, në Hagë.
21. Memorandumi i Mirëkuptimit në kornizën institucionale të Iniciativës për Përgatitjen dhe Parandalimin e Katastrofave në Evropën Jug-Lindore ", nëntor 2013.
22. Marrëveshja mes Shqipërisë dhe Kroacisë për bashkëpunim policor, të nënshkruar më 20.01.2014.
23. Protokolli Operacional mes të Policisë së Shtetit dhe Departamenti i Sigurisë Publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Italisë, më 30.01.2014.

Në vijim janë në procesin e negociatave dhe nënshkrimit:

- Hartimi dhe Rishikimi i Marrëveshjeve për Bashkëpunimin Policor me Kosovën, Rusinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

- Hartimi dhe Rishikimi i Marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Turqisë për bashkëpunim mes organeve të zbatimit të ligjit.
- Hartimi dhe Rishikimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Sllovakisë në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit dhe aktivitete të tjera të paligjshme.
- Programi i Përbashkët i Punës me Policinë Holandeze. (miratuar, u rishikuan në mënyrë të zgjeruar fushat e bashkëpunimit).
- Hartimi dhe Protokollit të një marrëveshje bashkëpunimi trepalëshe mes Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë, në luftën kundër trafikeve të paligjshme në det.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi për krijimin dhe funksionimin e Qendrës për Bashkëpunim policor të përbashkët në Muriqan.
- Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Greqisë për themelimin dhe funksionimin e Qendrës për Bashkëpunim Policor të përbashkët.
- Lidhja e një marrëveshje për të hapjen e pikës së të përbashkët Grabon-Zatrijebacka Cijena PKK në kufirin me Malin e Zi.
- Protokoll midis Shqipërisë dhe Portugalisë në zbatimin e marrëveshjes së ripranimit mes Shqipërisë dhe Komunitetit Europian.
- Protokollin e Ripranimit me Greqinë.
- Marrëveshja e Ripranimit dhe Protokollin e Zbatimit me Federatën Ruse.
- Marrëveshja e Ripranimit dhe Protokollin e Zbatimit me Ukrainën.
- Finalizimi i një marrëveshje dypalëshe me Serbinë dhe paraqitja e saj për miratim.
- Miratimi i marrëveshjes dypalëshe me Bosnje-Hercegovinën.

Përveç këtyre zhvillimeve, gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar operacione policore të suksesshme në bashkëpunim me autoritetet policore ndërkombëtare kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme. Gjatë vitit 2013, janë zhvilluar gjithsej 63 operacione me 145 persona të implikuar, nga të cilat 54 operacione në fushën e trafikut të narkotikëve, 7 operacione kundër trafikeve të tjera të paligjshme dhe 2 operacione në fushën e krimeve ekonomike. Vetëm për periudhën tremujore, janar-mars 2014, janë zhvilluar gjithsej 23 operacione ndërkombëtare me 33 persona të implikuar, nga të cilat 21 operacione kundër narkotikëve dhe 2 operacione kundër trafikeve të tjera. Shumica e operacioneve vazhdojnë të zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet policore Italiane dhe pjesa tjetër me Greqinë, Gjermaninë, Francën, Belgjikën, SELEC-un dhe vendet e tjera rajonale.

Gjatë vitit 2013, numri total i informacioneve të shkëmbyera nga ana e ZQK Interpol Tirana, Zyrës së Europol dhe Oficerëve ndërlidhës të Policisë së Shtetit është 138.896 kundërt 134.472 të shkëmbyera gjatë vitit 2012. Ndërsa gjatë tremujorit janar-mars 2014, janë shkëmbyer gjithsej 35.071 informacione me partnerët e huaj.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit

Lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit vazhdon të mbështetet në prioritetet dhe dokumentet strategjike të Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Shtetit.

Instrumentat kryesor për luftën kundër krimit të organizuar janë:

1. Strategjia Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar, Trafiqueve të Paligjshme dhe Terrorizmit 2013 – 2020 dhe Plani i saj i veprimit 2013-2016, miratuar me VKM nr.663, datë 17.07.2013;
2. Plani Kombëtar i Veprimit për 5 prioritetet (Roadmap 5) i cili shtrihet në vitet 2014 dhe 2015 dhe masat e përcaktuara në Prioritetin 4 “Lufta kundër Krimit të Organizuar”.

Duhet theksuar se shumica e objektivave dhe masave të parashikuara në Planin e Veprimit 2013-2016, të Strategjisë Ndërsektoriale, të mësipërme, janë përfshirë në Planin e Veprimit për 5 prioritetet, përveç masave të tjera të marra nga rekomandimet e dhëna nga raport progresi i KE.

Gjithashtu nga ana jonë po implementohen dhe monitorohen objektivat dhe masat e parashikuara në strategjitë dhe planet e veprimit që ndërthuren me strategjinë ndërsektoriale si më poshtë:

- a) Strategjia Kombëtare Antidrogë 2012-2016, miratuar me VKM nr.403, datë 20.06.2012;
- b) Strategjia Kombëtare Antikorrupsion 2008-2013, e cila ka përfunduar dhe aktualisht është në proces drafti i Strategjisë së Re 2014-2017;
- c) Dokumenti Strategjik Kombëtar për Luftën kundër Krimit Financiar 2009 – 2015;
- d) Strategjia Kombëtare Kundër Terrorizmit 2011-2015, miratuar me VKM Nr.675, datë 06.07.2011;
- e) Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Plani i saj i veprimit 2014-2020, e cila është miratuar me datë 5 Mars 2014;
- f) Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Dokumenti Plotësues “Plani i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit” 2011-2013, e cila ka përfunduar dhe aktualisht është duke u përgatitur drafti i Strategjisë së re që pritet të përfundojë në muajin qershor 2014;
- g) Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2014, e cila ka përfunduar dhe aktualisht ka filluar puna për hartimin e Strategjisë së re 2014-2020, që pritet të finalizohet brenda muajit qershor 2014;
- h) Strategjia për Zbatimin e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale 2010-2015;
- i) Planet Kombëtare të Veprimit lidhur me Trafikimin e Mjeteve Motorrike dhe Trafikimin e Veprave të Artit dhe Kulturës, të cilat përfundojnë këtë vit dhe do përgatiten Planet e reja të veprimit për periudhën 2014-2016.

Duke mbajtur në konsideratë Progres Raportin e KE për vitin 2013 dhe rekomandimet e tij, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Urdhërin Nr.120, datë 20.03.2014, për Ngritjen e Grupit të Punës për hartimin e “Dokumentit të Politikave për Sigurinë Kibernetike”.

Lidhur me Planin Kombëtar të Veprimit për 5 prioritetet (Roadmap 5) dhe masat e përcaktuara në Prioritetin 4, “Lufta kundër Krimit të Organizuar”, janë parashikuar nga si objektiva kryesore dhe masa, rekomandimet e dhëna nga raport progresi i KE dhe dokumenti “non paper” i dërguar nga Delegacioni i KE. Si objektiva kryesore të këtij Plani Veprimi përmendim:

1. Forcimi i koordinimit ndërinstitutional në luftën kundër krimit të organizuar;
2. Forcimi i luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, armëve dhe municioneve luftarake, mjeteve motorike dhe veprave të artit dhe kulturës;
3. Rritja e mëtejshme e masave për parandalimin dhe goditjen e pastrimit të parave, nëpërmjet forcimit të kapaciteve dhe rritjes së treguesve;
4. Përmirësimi i implementimit efektiv të ligjit antimafia, nëpërmjet ndryshimeve ligjore, që do të rezultojë në rritjen e treguesve;
5. Rritja e efektivitetit të strukturave të luftës kundër krimeve kompjuterike nëpërmjet riorganizimit strukturor dhe fuqizimit të kapaciteteve;
6. Thellimi i mëtejshëm i luftës kundër prodhimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike duke synuar në reduktimin e ofertës dhe aksesit ndaj drogave për përdorim të paligjshëm;
7. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal në drejtim të krimit të organizuar.

Masat e parashikuara në këtë Plan Veprimi kanë filluar të zbatohen dhe monitorohen dhe një pjesë e tyre kanë përfunduar.

Për rritjen e mëtejshme të bashkëpunimit ndërinstitutional është parashikuar marrja e aksesit në databaset e institucioneve të ndryshme dhe ndërtimi i një platforme të sigurtë për shkëmbimin e informacioneve ndërmjet agjensive të zbatimit të ligjit.

Në bazë edhe të rekomandimeve të dhëna nga raport progresi i fundit i KE dhe sugjerimet e misionit të ekspertëve të vitit 2013, në muajin mars 2014, janë propozuar ndryshime për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale”, i ndryshuar,. Propozimet i janë dërguar zyrtarisht Ministrisë së Drejtësisë me shkresën Nr. 2016/4 Datë 21 prill 2014 .

Disa nga ndryshimet e propozuara nga Policia e Shtetit shkurtimisht janë si më poshtë:

Kemi sugjeruar se duhet shtuar neni 294/c (dorëzimi i kontrolluar). Dorëzimi i kontrolluar është një teknikë që lejon kalimin në territorin e një ose më shumë shteteve të sendeve që nuk lejohen në qarkullimin e lirë ose sende që rrjedhin nga një krim (drogë, armë, para, etj), me dijeninë dhe nën mbikqyrjen e autoriteteve kompetente, me qëllim për të identifikuar personat e përfshirë në kryerjen e një krimi. Vendi ynë ka aderuar dhe nënshkruar disa Konventa Ndërkombëtare që sugjerojnë përdorimin e kësaj teknike nga vendet anëtare sic janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe të Lëndëve Psikotrope (aderuar me Ligjin Nr.8722, datë 26.12.2000), Konventa e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore (Ratifikuar me Ligjin 9604, datë 11.09.2006) si dhe Konventa e Palermos Kundër Krimit të Organizuar.

Lidhur me ndryshimet në nenin 294/a (veprimet simuluese) kemi sugjeruar se duhet riformuluar në tërësinë e tij pasi siç është paraqitur shumë i paqartë. Fjalja “Përdorja e pajisjeve të regjistrimit audio-video gjatë veprimit të simuluar duhet të autorizohet nga gjykata, sipas kërkesës së prokurorit” mendojme se duhet hequr pasi bie ndesh me nenin 222/a.

Për nenin 59 (i dëmtuari akuzues) paragrafi 1, është propozuar që kundravajtjet penale të parashikuara nga 90 (Dëmtime tjera me dashje), 91 (Plagosje e rëndë nga pakujdesia), 92 (Plagosje e lehtë nga pakujdesia), 148 (Botimi i veprës së tjetrit në emrin e vet) dhe 149 (Riprodhimi pa të drejtë i veprës së tjetrit) të hiqen nga paragrafi i parë i këtij neni dhe shtohen tek paragrafi i parë i nenit 284 (Ankimi).

Përsa i përket kundravajtjeve penale të parashikuara nga nenet 148 dhe 149, edhe Misioni Vlerësues i Bashkimit Europian në konkluzionet e dhëna mbi takimet e zhvilluara në datat 12–15 nëntor 2013, për vlerësimin e përparimit të bërë në Shqipëri në lidhje me respektimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale gjatë vitit 2013, ka rekomanduar që këto dy nene të hiqen nga neni 59 i K.Pr.P.

Lidhur me ndryshimet që propozojmë në nenin 190 (Disponimi për provat materiale), mendojmë se ato janë të domosdoshme. Nga partnerët ndërkombëtarë është sugjeruar që në rastet e sekuestrimit të sasirave të konsiderueshme të lëndëve narkotike, pjesa më e madhe e tyre të mund të asgjësohet përpara përfundimit të procesit gjyqësor dhe kjo të vlejë edhe për ngjarjet pa autor. Kjo praktikë zbatohet gjerësisht në vendet e BE-së.

Në nenin 199 (Këqyrja e personave), në pikën 4, është propozuar që të shtohen fjalët “Kryerja e grafisë dhe ekos”. Një nga mënyrat e trafikimit të lëndëve narkotike është transportimi i saj nga korrierë që gëlltisnin dhe mbajnë në stomak, kapsula të mbushura me drogë. Ka patur edhe në vendin tonë raste të tilla, të cilat mund të zbulohen vetëm nëpërmjet grafisë. Kjo teknikë përdoret rëndom në të gjitha vendet e BE-së.

Në nenin 303, “Dokumentimi i veprimeve të policisë gjyqësore” kemi propozuar të shtohet pika 3 me këtë përmbajtje, *“Policia gjyqësore gjatë fazës së hetimit, me kërkesë të prokurorit ose kur e çmon të nevojshme i dërgon prokurorit relacion shpjegues mbi veprimet hetimore të kryera, faktet dhe provat e administruara, si dhe mund ti sugjeroj nxjerrjen e urdhërave, vendimeve, apo pergatitjen e kërkesave për gjykatën për dhënien e autorizimeve apo marrjen e vendimeve për përgjime, caktimin e masave shtërnguese apo masa të sigurimit pasuror, e veprime tjera hetimore që vlerëson se janë të nevojshme për vijimin e hetimeve”*.

Në nenin 304 “Veprimtaria hetimore e prokurorit”, kemi propozuar të shtohet paragrafi 2 me këtë përmbajtje *“Në rastet kur ndjekja penale do të fillojë me materiale të dërguara nga shërbimet e policisë gjyqësore, prokurori delegon kryerjen e veprimeve hetimore oficerit/oficerëve që kanë bërë referimin e veprës penale. Në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të çështjes mund të urdhëroj kryerjen e veprimeve të mëtejshme proceduriale nga seksionet e policisë gjyqësore pranë*

prokurorisë, por duke përfshirë në hetimin e çështjes edhe të paktën 1 oficer të shërbimit të policisë gjyqësore që ka referuar çështjen”.

Pas nenit 344 është propozuar të shtohet neni 344/a më këtë përmbajtje: “Gjate shqyrtimit gjyqësor, në çështje penale komplekse, kur vazhdohet me procedurën e gjyqimit të zakonshëm, deri në fazën e kalimit në diskutimin perfundimtar, prokurori mund të thërrasë për konsultim në gjykim oficerin/oficerët e policisë gjyqësore që ka marrë pjesë në hetimin e çështjes penale”.

Në nenet 291 dhe 329, është propozuar që të drejtën e ankimit kundër vendimit të mosfillimit apo pushimit të çështjes penale përveç shtetasve që kanë bërë kallëzim apo ankim ta kenë edhe institucionet publike që bëjnë kallëzim në bazë të nenit 281 të K.Pr.P. si dhe institucioni nga i cili varet shërbimi i policisë gjyqësore, që ka kryer referimin e veprës penale në bazë të nenit 293 të K.Pr.P.

Referuar ndryshimeve të propozuara në nenin 24, paragrafi i dytë ku përcaktohet se “Prokurori ka të drejtë të mos regjistrojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në këtë Kod”, është propozuar që në nenin 291 paragrafi parë të përcaktohet “Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosregjistrimin e procedimit”.

Në paragrafin 2 të nenit 291 është propozuar që afati i ankimit nga 5 ditë të bëhet 10 ditë, pasi ky afat është i pamjaftueshëm për përgatitjen dhe dorëzimin e ankimit. Gjithashtu, kemi propozuar që paragrafi i dytë i nenit 329 të ndryshohet, duke përcaktuar që “ Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin vendos që hetimet të vazhdojnë, me një prokuror tjetër nga ai që ka kryer hetimet, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin”.

Efienca e hetimeve kundër krimit të organizuar:

Veprat Penale: Krimi Organizuar dhe Korrupsioni

Nr	Vepra Penale	2012	2013	%	janar-mars 2013	janar-mars 2014	%
1	Veprat penale në fushën e narkotikëve	962	1105	15%	289	328	13.5%
1.1	Rastet Heroinë	90	95	5.6%	27	21	-22%
1.2	Rastet Kokainë	40	42	5%	8	22	175%
1.3	Rastet Marijuana	822	949	15.5%	250	284	13.2%
2	Veprat penale në fushën e trafikeve të paligjshme	601	413	-31.3%	116	129	11.2%
2.1	Trafikimi i qenieve njerëzore	30	53	76.7%	6	16	166.7%
2.2	Trafikimi i mjeteve motorike	420	252	-40%	71	67	-5.6%

2.3	Trafikimi i armëve dhe municioneve	19	13	-31.6%	3	10	233%
3	Pastrimi i Produkteve të veprës penale	114	87	-23.7%	30	30	0%
4	Veprat penale të Korrupsionit	432	458	6%	121	145	19.8%
5	Veprat penale të Krimeve Kompjuterike	83	108	30.1%	18	35	94.4%

Përdorimi i Metodave Speciale të Hetimit për vitin 2013 dhe janar-mars 2014

Type of Crime for which SIM are implemented	No of SIM implemented in 2013	No of SIM implemented Jan - March 2014
Drug Trafficking and Drug Sale	173	54
Other Illegal Trafficking and Prostitution	159	52
Corruption cases	81	29
Economic and Financial Crime	59	17
Money Laundering cases	7	2
Computer Crime	6	4
Terrorism	2	7
TOTAL	487	165

Gjatë vitit 2013, shumica e indikatorëve të luftës kundër krimit të organizuar kanë qenë të qëndrueshëm. Pavarësisht një rënie në veprat e trafikimit të paligjshëm apo pastrimit të parave, gjatë tremujorit të fundit të vitit 2013 treguesit kanë pasur një trend rritës duke pasqyruar numrin në rritje të hetimeve edhe në këto fusha.

Për veprat penale të **trafiqeve të paligjshme**, pavarësisht rënies gjatë vitit 2013, po të krahasojmë të dhënat statistikore për periudhën janar-mars 2014, me të njëjtën periudhë të vitit 2013, rezulton se ka një rritje të numrit të veprave penale të evidentuara me 13 vepra më tepër, rritje shënon edhe numri i autorëve të përfshirë në trafike të paligjshme, me 46 autorë.

Gjatë tremujorit të parë janar-mars 2014, të gjithë treguesit kanë rritje. Hetimet proaktive janë përdorur shpesh në shumicën e rasteve të krimit të organizuar. Rastet e kapjeve dhe sasisë të lëndëve narkotike janë rritur veçanërisht për Kokainën dhe Marijuanën. Edhe rastet e krimit kompjuterik janë në rritje gjatë vitit 2014.

Përdorimi i Metodave Speciale të Hetimit (SIM) tashmë është diçka e zakonshme për shumicën e operacioneve policore kundër trafikut të narkotikëve. Gjatë vitit 2013, SIM janë përdorur në 487 raste dhe vetëm për periudhën janar-mars 2014, janë përdorur në 165 raste. Siç duket trendi për vitin 2014 është në rritje.

Edhe përdorimi i agentëve të policisë nën mbulim dhe numri i operacioneve me përdorimin e tyre është rritur gjatë vitit 2013 dhe tremujorit të parë 2014.

Structure	Year 2010	Year 2011	Year 2012	Year 2013	Jan-March 2014
NARCOTICS	6	12	17	12	5
ILLEGAL TRAFFICKING	1	2	1	4	8
FINANCIAL CRIME	6	9	7	5	3
TERRORISM	0	0	0	1	1
TOTAL	13	23	25	22	17

Numri i operacioneve gjatë Tremujorit të parë 2014 është pak a shumë i njëjtë me numrin e operacioneve të zhvilluara gjatë gjithë vitit 2013. Theksojmë se operacionet me përdorimin e agentëve nën mbulim janë zhvilluar jo vetëm brenda territorit të RSH-së por dhe në vende të tjera të BE-së duke kontribuar në finalizimin e sukseshëm të këtyre operacioneve ndërkombëtare.

Nga ana e strukturave të forcës së posaçme operacionale janë ngritur grupet e punës për hartimin e Udhëzimeve vijuese:

- “Për procedurat standarte të agentëve të infiltruar”;
- “Për veprimet e vëzhgimit teknik e konvencional”;
- “Për procedurat e përgjimit ambiental”.

Gjithashtu, janë marrë masa për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të këtyre strukturave nëpërmjet trajnimeve dhe përmirësimit të pajisjeve.

Situata në fushën e Krimeve Kompjuterike

Në vijim të rezultateve pozitive të arritura në vitin 2013, vetëm gjatë periudhës janar - mars 2014, nga ana e strukturave për krimin kompjuterik janë evidentuar 35 vepra penale, zbuluar 20, janë proceduar 26 autorë të veprave penale, të cilët ndiqen në gjendje të lirë. Krahësuar me të njëjtën periudhë paraardhëse, janë evidentuar 17 vepra penale më shumë, me 11 autorë më shumë në gjendje të lirë.

Gjatë periudhës raportuese janë konstatuar format e mëposhtme të krimit kompjuterik:

- a) Mashtrimet nëpërmejt internetit;
- b) Mashtrimet me karta bankare;
- c) Falsifikimet kompjuterike;
- d) Ndërhijet e paligjshme kompjuterike;
- e) Pornografia me të mitur në internet.

Eshtë parashikuar forcimi i kapaciteteve dhe ristrukturimi i Sektorit për Krimet Kompjuterike, në Policinë e Shtetit. Ky sektor do të riorganizohet si një njësi e përqëndruar në varësi të Zëvendësdirëtorit të Përgjithshëm për Krimin e Organizuar.

Gjithashtu, janë blerë pajisje dhe programe të reja kompjuterike për ekzaminimin dhe kërkimin e të dhënave kompjuterike, në funksion të rritjes së kapaciteteve.

Hetimi i Aseteve Kriminale në zbatim të ligjit Antimafia

Mbështetur në rekomandimin e Raport Progres-it të BE-së për vitin 2013 në lidhje me hetimin e asetëve kriminale, ku citojmë: *“Vazhdojnë problemet në zbatim të ligjit Antimafia, sidomos në lidhje me konfiskimin e pasurisë. Duhet të shtohen hetimet kryesisht (proaktive) ndaj pasurive me origjinë nga veprimtari kriminale jashtë shtetit, por që investohen në Shqipëri. Duhet të përmirësohet bashkëpunimi midis Policisë dhe Prokurorisë, si dhe duhen përforcuar kapacitetet e policisë që t’i përgjigjet siç duhet dhe në kohë kërkesave të prokurorisë për përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit”*, Policia e Shtetit ka rritur angazhimin e saj në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit nëpërmjet hetimit të asetëve kriminale.

Gjatë kësaj periudhe është zgjeruar fusha e veprimit të ligjit antimafia duke përfshirë në objektin e veprimtarisë së tij disa nene të korrupsionit. Këto amendime janë bërë në seancën plenare të Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, në datën 20.03.2014.

Gjithashtu, nga asetet e konfiskuara, Policia e Shtetit ka përfituar një fond të veçantë prej 14 milion lekë, vënë në dispozicion nga Ministria e Financave. Ky fond ka filluar të prokurohet për blerjen e një sërë pajisjesh që do të ndihmojnë luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet sekuestrimit dhe konfiskimit të asetëve të krimit.

Treguesit për Asetet Kriminale viti 2013

Gjatë vitit 2013, nga strukturat për asetet kriminale në Policinë e Shtetit janë referuar për në Prokurorinë e Krimeve të Rënda 79 materiale për fillimin e procedimit pasuror, me 92 subjekte, ndërsa për të njëjtën periudhë të vitit 2012, janë referuar 87 materiale.

- a. **Sekuestrimet:** Janë dhënë 2 vendime për sekuestrimin e pasurive (2 prona të paluajtshme dhe 6 llogarive bankare). Nga të cilat, një vendim është revokuar në gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda (për një pronë të paluajtshme).
- b. **Konfiskimet.** Janë dhënë 3 vendime për konfiskimin e pasurive (2 apartamente banimi, 3 aktivitete biznesi, 4 llogari bankare).
- c. **Revokimet:** Janë dhënë 5 vendime nga gjykatat për revokimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara (konkretisht 16 pasuri të paluajtshme, prej të cilave një aktivitet biznesi dhe 30 llogari bankare).

Treguesit për Asetet Kriminale janar – mars 2014

Gjatë periudhës janar – mars 2014, si rezultat i punës së bërë mbi verifikimet pasurore, nga strukturat e Policisë së Shtetit janë referuar në Prokurorinë për Krime të Rënda 31 materiale për fillimin e procedimit pasuror për 35 subjekte. Në të njëjtën periudhë të një viti më parë janë referuar 24 materiale për 31 subjekte.

Sekuestrimet: Në drejtim të sekuestrimit gjatë kësaj periudhe janë marrë 2 vendime për sekuestro nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për 3 llogari bankare dhe 7 prona të paluajtshme. Në total janë sekuestruar 312.500 Euro, 8.271.000 lekë dhe 7 (shtatë) pasuri të paluajtshme në qarkun e Durrësit.

Lufta kundër Terrorizmit

Gjatë vitit 2013 dhe tre mujorit të parë të vitit 2014, strukturat e luftës kundër Akteve Terroriste në DPPSH dhe Prokuroria për Krimet e Rënda e kanë rritur shkallën e bashkëpunimit në ndjekjen dhe hetimin e veprave penale, objekt të këtyre strukturave. Po kështu për disa çështje të veçanta bashkëpunimi me shërbimet inteligjente ka njohur rritje sidomos në shkëmbimin e informacioneve në kohë dhe përmirësimin e kanaleve të komunikimit, në veçanti përmes takimeve periodike.

Në drejtim të legjislacionit, Republika e Shqipërisë ka përshtatur dhe vazhdon të përshtasë kuadrin ligjor për luftën kundër terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e “Vendimit Kuadër të Këshillit të Evropës mbi Luftën Kundër Terrorizmit”, Luksemburg, më 13.06.2002, i cili kërkon që përcaktimi i krimeve terroriste të përafrohet në të gjitha shtetet anëtare, duke përfshirë ato krime që lidhen me grupet terroriste.

a). Është në proces hartimi i Projekt-Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e Komitetit Ndërinstitucional për bashkërendimin e veprimeve në luftën kundër terrorizmit”, i cili do të finalizohet në katër mujorin e dytë të këtij viti.

b). Është në proces krijimi i një njësie të specializuar për ndjekjen e individëve dhe grupeve me prirje radikale apo ekstremiste, si dhe po punohet për përmirësimin e mënyrave të bashkëpunimit midis agjencive të zbatimit të ligjit dhe me organizmat rajonale dhe ndërkombëtare që marrin pjesë në luftën kundër terrorizmit.

c). Nisur nga situata aktuale dhe përmasat në rritje të rekrutimit të shtetasve shqiptarë që përfshihen në formacione ushtarake apo grupe e njësi të armatosura në disa vende në konflikt, Ministria e Punëve të Brendshme po ndërmerr një nismë ligjore, për ndryshime në Kodin Penal të RSH-së, për ta cilësuar këtë veprimtari si vepër penale dhe për të ashpërsuar masat e dënimit.

Strukturat e luftës kundër Akteve Terroriste kanë vazhduar zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe planin e veprimit të luftës kundër terrorizmit. Hetimet e fundit e bëjnë akoma më të qartë se vendi ynë duhet të adresojë rekomandimet e Task-Forcës së Aksionit Financiar (FATF) mbi pasuritë e terrorizmit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me financimin e terrorizmit.

Në 9 janar 2013, është nënshkruar një memorandum për bashkëpunimin më të gjerë midis institucioneve të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit. Numri i hetimeve dhe çështjeve që i janë paraqitur Prokurorisë është rritur.

Janë zhvilluar trajnime të përbashkëta për oficerët e policisë dhe të prokurorisë, përfshi trajnime për konfiskimin e pasurive kriminale dhe krimin kibernetik. Është përmirësuar bashkëpunimi midis Njësisë Hetimore Financiare (NjHF) dhe Policisë.

Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërkombëtar, mbetet prioritet i Policisë së Shtetit. Këto marrëdhënie shërbejnë kryesisht për shkëmbimin e shpejtë të informacionit, përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e nënshkruara, aktet ndërkombëtare dhe iniciativat rajonale, shkëmbimin e eksperiencave në shërbim të forcimit të kapaciteteve profesionale, si dhe pjesëmarrjes në seminare, workshop-e, dhe trajnime.

Më 27-28 janar 2014, në Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit në bashkëpunim me Akademinë e Ligjit Evropian (ERA), zhvilloi një seminar me temë “Lufta Kundër Terrorizmit - Standardet e BE-së, bashkëpunim ndërkombëtar dhe eksperiencia nga vendet anëtare të JHA”. Po kështu, gjatë vitit 2014, janë parashikuar një sërë trajnimesh për oficerët e policisë së Strukturave për Aktet Terroriste.

Për sa i përket kapaciteteve profesionale dhe logjistike strukturat për aktet terroriste janë në një fazë studimi e vlerësimi për një riorganizim, në funksion të tendencave dhe detyrimeve që rrjedhin nga Raport-Progresi i vitit kaluar dhe marrëveshja e MSA-së.

Gjatë kësaj periudhe, strukturat për Aktet Terroriste në Policinë e Shtetit kanë realizuar dy operacione të rëndësishme kundër akteve terroriste, konkretisht:

- Me datë 25.01.2014, janë arrestuar 4 shtetas dhe 1 në kërkim për veprën penale “akte terroriste”, sipas nenit 230 të Kodit Penal.
- Me datë 11.03.2014, në kuadër të ekzekutimit të urdhrave të Gjykatës për Krimet e Rënda për 13 shtetas të dyshuar për Nenet 231 dhe 232/a të Kodit Penal, u bë i mundur arrestimi i 9 shtetasve dhe shpallja në kërkim e 4 të tjerëve që rezultojnë të jenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Mbështetja në produktet analitike dhe inteligjencën, në funksion të hetimeve proaktive për krimin e organizuar.

Implementimi i Modelit Kombëtar të Inteligjencës ka standartizuar procedurat për mbledhjen dhe manaxhimin e informacionit si dhe përgatitjes së produkteve analitike cilësore. Ky model thekson rolin e rëndësishëm të analistit brenda organizatës policore. Shumica e produkteve analitike bazohen në procedurat standarte. Në vitin 2013 ato zinin 70 % të gjithë produkteve analitike. Produkti më i rëndësishëm i bazuar në këtë model është SOCTA.

Gjatë vitit 2013, janë hartuar 568 produkte analitike, ndërsa vetëm për periudhën janar-mars 2014, nga strukturat e Analizës së Informacionit Kriminal janë hartuar 23 raporteve analitike, prej të cilave 11 raporte janë hartuar mbi bazën e kërkesave për analizë të prokurorisë të rretheve gjyqësore dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, 5 raporte mbi bazën e kërkesës së strukturave qendrore dhe vendore të policisë, 1 raport

me kërkesë të agjencive të tjera, 3 raporte mbi bazën e procedurave standarde të miratuara dhe 3 raporte me iniciativën e analistëve.

Veçojmë faktin se me kërkesë të Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Krimin e Organizuar dhe Krimet e Rënda është hartuar raporti analitik “Profil problemi për shkatërrimin e pronës me eksploziv, për periudhën janar 2013–mars 2014”.

Lidhur me raporte analitike të hartuara në bazë të procedurave standarde të miratuara është hartuar raporti analitik “Vlerësimi i kërcënimit për krimin e organizuar dhe krimet e rënda për vitin 2014” si dhe raporti analitik “Vlerësimi strategjik për krimin e organizuar dhe krimet e rënda, për vitin 2013”.

Në zbatim të procedurave të normuara me udhër nr.996, datë 01.09.2009, të Drejtorit të Përgjithshëm “Për miratimin e udhëzuesit për vlerësimin e rrezikshmërisë së grupeve kriminale” është hartuar raporti analitik “Vlerësimi i rrezikshmërisë së grupeve kriminale, për vitin 2014”.

Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë

Drejtoria e MD&BD, ka vazhduar veprimtarinë në mbështetje të Ligjit. nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”, Ligjit nr.10173, datë 22.10.2009 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë”, dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore. Aktualisht po zbatohen masa të posaçme të mbrojtjes për një numër të konsiderueshëm personash, që klasifikohen dëshmitarë drejtësie, bashkëpunëtorë drejtësie, persona të lidhur me dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë.

Është realizuar akomodimi i Drejtorisë së MD në ndërtesën e re, investim i qeverisë Shqiptare me vlerë 2.7 milion dollarë. Kjo ndërtesë plotëson të gjitha parametrat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore. Buxheti vjetor për vitin 2014, në funksion të programit të mbrojtjes është 32 milion ALL, nga të cilat janë disbursuar 9 milion ALL.

Drejtoria e MD&BD është përfituese e Projektit IPA 2012, me temë “Bashkëpunimi në Drejtësinë Penale: Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën Kundër Krimeve të Rënda dhe Terrorizmi (WINPRO)”, financuar nga BE. Për 3-mujorin e parë 2014, janë zhvilluar trajnime dhe seminare, me pjesëmarrjen e 28 punonjësve.

Pastrimi i Parave, krimi ekonomik dhe financiar

Lufta kundër Pastrimit të Parave vazhdon të mbetet një nga prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe Policisë së Shtetit. Në zbatim të Plan-Veprimit, Prioritet 4 “Lufta kundër krimit të organizuar” janë plotësuar prioritetet e mëposhtme:

Gjatë periudhës janar-mars 2014, janë zhvilluar trajnimet e përbashkëta me Prokurorinë, DPPP, TAEX, dhe institucione të tjera në fushën e pastrimit të parave, përcaktuar si prioritet në pikën 3.1.4.1 të Plan Veprimit.

Janë zhvilluar 6 trajnime, 2 në Qendrën e Formimit Policor, 1 në Mal të Zi, 2 në DPPSH.

Në zbatim të prioritetit të përcaktuar në pikën 1.2.3.2 të Planit të Veprimit prioriteti 4, është marrë akses në database-it e DPPP-së, për rastet e dyshimta që dërgohen nga ana e tyre.

Në zbatim të Memorandumit të Bashkëpunimit nr. 940/2, datë 14.02.2013 "Për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore për Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave" ndërmjet Ministrit Brendshëm, Ministrit Financave, Ministrit Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, vazhdon bashkëpunimi mes strukturave të pastrimit të parave në Policinë e Shtetit, Prokurorisë dhe DPPP për shkëmbimin e informacioneve.

Në zbatim të prioritetit të përcaktuar në pikën 1.2.3.3 "Rritja e efektivitetit dhe efikasitetit të bashkëpunimit operacional, midis DPPSH, DPPP dhe Prokurorit të Përgjithshëm", gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar midis këtyre institucioneve një sërë takimesh për problemet në fushën e hetimeve të pastrimit të parave.

Në funksion të forcimit të kapaciteteve të hetimit të pastrimit të parave është hartuar Plani i Kontrollit për analizimin e boshllëqeve të strukturave vendore, ku për periudhën janar-mars 2014, janë përfunduar kontrollet në DPQ Kukës, Korçë, Dibër, Lezhë dhe Shkodër.

Gjatë vitit 2013, në fushën e pastrimit të parave janë evidentuar **87** vepra penale me **109** autorë. Nga këto **48** raste janë me informacione të ardhura nga DPPP dhe **39** raste janë me indicje policore. Të ndara sipas veprës bazë që kanë gjeneruar pastrimin e parave:

- 49 "Trafiku i lëndëve narkotike".
- 32 "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale"
- 1 "Shfrytëzimi i prostitucionit".
- 1 "Trafiku i qenieve njerëzore".
- 1 "Evazioni fiskal".
- 3 "Shpërdorimi i detyrës".

Për pastrim të produkteve të veprës penale krahasuar me vitin 2012, rezultojnë 27 vepra penale më pak ose 23.7% më pak. Pavarësisht uljes së lehtë të veprave penale në vitin 2013, për periudhën janar-mars 2014, treguesit janë të qëndrueshëm dhe pozitiv.

Gjatë periudhës janar-mars 2014, për pastrim produktesh të veprës penale (neni 287 i Kodit Penal), janë evidentuar: 30 vepra penale, me 39 autorë të implikuar. Nga rastet e referuara në prokurori 15 janë me informacione të ardhura nga D.P.P.P dhe 15 me indicje policore. Krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton; i njëjti numër veprash penale.

Të ndara sipas veprës bazë që kanë gjeneruar pastrimin e parave:

- 18 "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".
- 9 "Trafik ndërkombëtar i lëndëve narkotike".
- 1 "Korrupsion pasiv".
- 1 "Shfrytëzim prostitucioni dhe pjesëmarrje në organizatë kriminale".

- 1 "Vjedhje me shpërdorim detyrë".

Për periudhën janar-mars 2014, janë 2 hetime proaktive që ndiqen me metoda speciale të hetimit.

Sekuestrimet për periudhën janar-mars 2014

Janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", shuma me vlere rreth 820 000 Euro. Në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton se gjatë tre mujorit të parë të vitit 2013 janë sekuestruar, për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", shuma me vlerë 11 600 000 ALL.

Krimi Ekonomik Financiar

Gjatë vitit 2013, për krime ekonomike janë evidentuar 2318 vepra penale, me 2391 autor, prej te cilëve 124 të arrestuar, 2246 të hetuar në gjendje të lirë dhe 21 të shpallur në kërkim.

Nga krahasimi i treguesve, rezulton se:

- gjatë vitit 2013 u evidentuan 524 vepra penale më shumë se në vitin 2012, numri i veprave penale të zbuluara është rritur në masën 30.5%.
- u proceduan penalisht 445 autor më shumë se vitin e kaluar ose 22.8% më shumë.

Pjesa me e madhe e veprave penale janë evidentuar gjatë periudhës tetor-dhjetor 2013, veçanërisht në drejtim të goditjes së aktivitetit të kundërligjshëm të lojërave të fatit.

Janë kryer 38 operacione policore për goditjen e grupeve kriminale (grupeve me mbi tre autor), të përfshira në veprimtari të ndryshme kriminale në fushën e krimit ekonomik e financiar, kryesisht në veprat penale të kontrabandës e mashtrimit financiar dhe zbulimit e goditjes së bazave të falsifikimit të monedhave apo dokumenteve, ku janë proceduar penalisht 146 autorë, nga të cilët 108 të arrestuar dhe të ndaluar, 37 të hetuar në gjendje të lirë dhe 1 i shpallur në kërkim. Nga krahasimi, rezulton se në vitin 2013 u u realizuan 6 operacione policore më shumë se në vitin 2012, me 5 autorë më tepër.

Nga operacionet policore si më të suksesshme veçojmë operacionin **"FUND MARRËZISË"** për goditjen e aktivitetit të kundërligjshëm të lojërave të fatit, ku u kontrolluan në shkallë vendi 1553 subjekte, u evidentuan në total 720 vepra penale "Zhvillim i palejuar i lojërave të fatit", me 714 autor të kallëzuar për ndjekje penale në gjendje të lirë, u sekuestruan 3710 pajisje të lojërave të fatit dhe 291 kompjutera e 718 televizorë në pikat të jashtëligjshme të basteve.

Gjithashtu kanë përfunduar me sukses dhe operacionet ndërkombëtare të koduara **"MËRKURI I BARDHË 1"** dhe **"MËRKURI I BARDHË 2"**, për goditjen e aktivitetit të tregtimit, prodhimit dhe mbajtjes së mallrave të falsifikuara, organizuar nga INTERPOL-i, në bashkëpunim me disa vende të Ballkanit (Shqipëria, Bosnja & Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia) dhe nën mbështetjen

e Komisionit European, të zhvilluara nga datat 30 shtator-06 tetor 2013, dhe 28 tetor-03 nëntor 2013, ku u evidentuan në total 25 vepra penale në fushën e shkeljes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe industriale, me 25 autor prej të cilëve 2 të arrestuar në flagrancë dhe 23 të proceduar penalisht në gjendje të lirë si dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale një sasi e konsiderueshme produkte të falsifikuara.

Gjatë tremujorit të parë 2014, janë evidentuar 617 vepra penale, nga të cilat u zbuluan 599, ose 97% e tyre, me 672 autor, prej të cilëve 42 të arrestuar dhe ndaluar, 623 të hetuar në gjendje të lirë dhe 7 të shpallur në kërkim. Nga krahasimi i treguesve rezulton se, gjatë këtij tremujori u evidentuan 158 vepra penale, më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ose me një rritje prej 34.4 %, si dhe u proceduan 170 autorë më shumë ose me një rritje prej 33.8 %, ndërsa numri i autorëve të arrestuar është 9 më shumë ose me një rritje prej 27.2 %.

Po gjatë këtij tremujori u realizuan 13 operacione policore, me 44 autorë, prej të cilëve 30 të arrestuar, 9 në kërkim dhe 6 në gjendje të lirë. Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar u realizua 1 operacion policor më pak.

Rritja e këtyre treguesve ka ardhur edhe si rezultat i ndryshimeve që ju bënë kodit penal me ligjin nr 144/2013, ku u shtua neni 144/a “Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar, si dhe u ndryshua neni 180 “Fshehja e të ardhurave”, ku në bazë të këtij neni ndaj një subjekti që fsheh të ardhurat, mund të filloj ndjekja penale pa qenë e nevojshme që subjekti të jetë proceduar më parë administrativisht nga organet tatimore (siç përcaktohej më parë në këtë nen).

Janë përmbushur detyrimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale dhe Industriale 2010-2015”, miratuar me VKM Nr.760, datë 1.9.2010.

Është planifikuar të përgatitet një projekt marrëveshje bashkëpunimi në fushën e luftës kundër falsifikimit të parave me Bankën e Shqipërisë për forcimin e bashkëpunimit si dhe mundësinë e shkëmbimit të informacionit midis dy institucioneve.

Do të propozohet shtimi i një neni në Kodin Penal, ku të parashikohet që prodhimi, importimi, trafikimi apo tregtimi me çfarë do lloj mjeti i barnave të falsifikuara apo substancave të tjera të ngjashme të penalizohet edhe pa qenë nevoja e kërcënimit të Shëndetit Publik.

Do të propozohet përgatitja e projekt-akteve ligjore për ratifikimin e Konventës “Për Produktet Mjekësore të Falsifikuara dhe Krimeve të tjera të ngjashme që kërcënojnë Shëndetin Publik”.

Trafikimi i personave

Gjatë kësaj periudhe prioritet i punës së Ministrisë së Punëve të Brendshme ka qenë parandalimi dhe lufta kundër trafikimit të personave, me fokus të veçantë adresimin e

trafikimit të brendshëm dhe trafikimit të fëmijëve. Është rritur numri i hetimeve proaktive dhe identifikimet fillestare të viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe është rritur bashkëpunimi me autoritetet policore të vendeve të rajonit dhe BE-së në të cilat rezulton se viktimat shqiptare të trafikimit shfrytëzohen për prostitucion, punë, etj.

Ndër masat më të rëndësishme në këtë fushë përmendim:

Hartimi, miratimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave duhet të zbatohet nëpërmjet një qasjeje holistike dhe ndërdisiplinore.

Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011-2013” si dhe “Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit 2011-2013” drejtoi politikat dhe masat përgjatë vitit 2013.

- Plani i fundit i veprimit është hartuar nga ZKKA në konsulencë me agjenci shtetërore, ndërkombëtare dhe OJF. Njësia Antitrafik menaxhoi një proces të gjatë dhe gjithëpërfshirës të hartimit të strategjisë. I njëjti proces i gjerë konsultimi po ndodh edhe me hartimin e strategjisë së re për 2014-2016. Roundi i parë i takimeve konsultative u krye në muajin prill me aktorë shtetërorë, shoqërinë civile dhe organizata ndërkombëtare. Afatet e procesit janë tashmë të përcaktuara dhe workshop-i i parë është planifikuar të organizohet në javën e parë të muajit maj. I gjithë procesi i hartimit të dokumentit të ri strategjik parashikohet të finalizohet në fund të muajit qershor..

Legjislacioni:

- Në 2 maj 2013 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin e ri nr. 144/2013 "Për disa ndryshime në Ligjin nr 7895, datë 27.1.1995" Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ", i ndryshuar.
 - Neni 114/a i KP për "Shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese" dhe neni 114 / b "Trafikimi i femrave" janë shfuqizuar me ligjin e përmendur më lart në këtë mënyrë nuk konkurrojnë më me nenet e trafikimit.
 - Neni 110/a "Trafikimi i personave" i KP ka ndryshuar në "Trafikimin e personave të rritur". Neni i ri për trafikimin e personave të rritur është ndryshuar duke dalluar trafikimin e brendshëm nga trafikimi ndërkufitar duke i dhënë në këtë mënyrë fund kontestimeve ligjore lidhur me zbatimin e këtij neni edhe për rastet e trafikimit të brendshëm.
 - Neni i ri 52/a paragrafi i dytë, përcakton garanton mosdënimin e viktimave të trafikimit për përfshirjen e tyre në aktivitete kriminale, të cilat ata kanë qenë të detyruara t'i kryejnë si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenurit viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. (Neni 52 / a paragrafin (II).
 - Një nen i ri, neni 110/b i KP është shtuar "Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar" përcakton kriminalizimin e përdorimit të shërbimeve të viktimave të trafikimit dhe të atyre që përfitojnë nga shërbimet e tyre dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

- Një nen tjetër i ri, neni 110/c i KP është shtuar "Veprimet që lehtësojnë trafikimin", që parashikon se falsifikimi, posedimi, apo ofrimi i kartave të identitetit, pasaportave, vizave apo dokumenteve të tjera të udhëtimit, ose mbajtjen e tyre, heqjen, fshehjen, dëmtimin ose shkatërrimin në mënyrë për të mundësuar trafikimin e personave mbi 18 vjeç përbën vepër penale dhe dënohet me dy deri në pesë vjet burgim.
- Në maj 2013 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 143/2013 " Mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 10039, datë 22.12.2008 "Për ndihmën juridike".

Ligji parashikon ndryshime të rëndësishme në kuadër të rritjes së qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 143/2013, njerëzit që kanë nevojë për të mbrojtur të drejtat e tyre, me anë të parashtrimit të kërkesës, por nuk kanë para të mjaftueshme për të paguar tatimin mbi aktet dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore, për të marrë ndihmë juridike duhet të vërtetojë se janë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale ose që kanë të drejtë që të përfshihen në to ose janë viktimat e dhunës në familje ose viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, lidhur me çështjet gjyqësore. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ka miratuar aktet nënligjore, të cilat ofrojnë një rregullore më të detajuar në lidhje me prioritetet në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike shtetërore.

Është hartuar draft VKM-ja për funksionimin e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe relacioni përkatës. Ndryshimi i vendimit për ngritjen e Komitetit Shtetëror është rrjedhojë e nevojës për ta përshtatur këtë strukturë me dinamikën e zhvillimeve të reja lidhur me trafikimin e personave, si dhe për të krijuar një vizion të ri në qasjen ndaj fenomenit të trafikimit të personave. Ky mekanizëm, më i rëndësishmi në nivel politik, është përgjegjës për përcaktimin e përparësive strategjike mbi të cilat do të mbështetet veprimi anti-trafikim në Shqipëri. Me këto ndryshime mendohet të qartësohet si përbërja e Komitetit duke shtuar edhe anëtarë të rinj, ashtu edhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij, për ta bërë atë sa më funksional dhe një instrument të dobishëm për të nxitur, siguruar kapacitetet, angazhimin dhe vullnetin e duhur për t'u përballur seriozisht me fenomenin e trafikimit të personave. Deri tani ne kemi marrë konfirmim nga të gjitha ministratë në anëtarësimin e tyre.

- NjAT përgatiti dhe dërgoi për mendim draft Urdhrin "Për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të mundshme të trafikimit". Rishikimi i urdhrin për ngritjen e Autoritetit Përgjegjës në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes për Mekanizmin Kombëtar të Referimit nënshkruar më 15.06.2012, si dhe Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit do të mundësojë zbatimin efektiv të marrëveshjeve të nënshkruara për mbrojtjen dhe asistencën e fëmijëve viktimat të trafikimit, funksionimin e MKR-së, si edhe monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të ardhshme të mundshme bilaterale

dhe multilaterale midis Shqipërisë dhe vendeve të tjera në rajon dhe më gjerë, lidhur me problemet e trafikimit të personave. Draft Urdhri është dërguar për mendim tek të gjithë anëtarët e AP ekzistues dhe anëtarët e rinj të propozuar. Është nënshkruar Urdhri i Përbashkët i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Nr. 332/3, datë 07.03.2014 dhe Shërbimit Social Shtetëror, Nr. 562, datë 12.03.2014 “Mbi pritjen dhe trajtimin social të minorenëve të pashoqëruar apo të kthyer nga jashtë shtetit”.

Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit:

- Koordinatori Kombëtar Antitrafik ka propozuar ngritjen e një Task Force mes Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Policisë së Shtetit me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre organeve dhe për të diskutuar raste konkrete të trafikimit të personave. Në 19 dhjetor, 2013 Koordinatori Kombëtar organizoi një takim me kryetarin e Gjykatës së Krimeve të Rënda, Drejtuesin e Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të diskutuar mënyrat e ngritjes së një Task Force ndërmjet institucioneve të lartpërmendura që do të forcojë bashkëpunimin ndërinstitutional dhe të japë rekomandime. ZKKA e ndihmuar nga ICITAP ka hartuar Termat e Referencës për Task Forcën. Më 10 mars 2014 KK zhvilloi një takim me drejtuesit e Policisë së Shtetit, Prokurorisë për Krimet e Rënda, OPDAT, ICITAP dhe PAMECA për të diskutuar mbi Termat e Referencës për Task Forcën në analizimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.
- Më 23 janar 2014, u mbajt një konferencë kombëtare , në Tiranë, me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri për çështjet që lidhen me hetimin dhe gjykimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo konferencë është kryesuar nga Koordinatori Kombëtar Antitrafik duke sjellë bashkë aktorët kyç nga Policia, Prokuroria dhe Gjykata për Krime të Rënda, Organizatat Ndërkombëtare, OJF-të ku u ndanë zhvillimet më të fundit dhe shqetësimet në fushën e identifikimit, hetimit proaktiv dhe çështjet gjyqësore lidhur me trafikimin të qenieve njerëzore.
- Me propozimin e KK dhe NjAT, me urdhër të Ministrit të MPB, është krijuar një grup pune për hartimin e Protokollit të Bashkëpunimit me Malin e Zi. Draft Protokollit i është dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme për komente/mendim. Aktualisht, projekt-protokollit i është dërguar homologut malazez për komente.
- Një takim me homologët kosovarë është realizuar në Prishtinë më 27-28 mars, ku u diskutuan çështje të bashkëpunimit mes dy vendeve për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, si edhe për të përmirësuar identifikimin, njoftimin dhe kthimin e asistuar vullnetar të VT/VMT.

Trajnime

Trajnime mbi trafikimin e personave (2014):

- Gjatë periudhës së raportimit 6 trajnime janë zhvilluar nga Policia. Gjatë periudhës së raportimit 6 trajnime janë organizuar nga Shkolla e Magjistraturës.
- Në bashkëpunim me IOM, Njësia Antitrafik organizoi më datë 22 janar një trajnim ndërgjegjësues me operatorët turistikë mbi trafikimin e personave.
- Çdo vit për të gjitha strukturat e Policisë, Prokurorinë, Gjykatat, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe shoqërinë civile janë zhvilluar disa trajnime me tematika të ndryshme lidhur me fenomenin e trafikimit si për njohjen me kuadrit ligjor, kuptimin e fenomenit, për format e shfaqjes, pasojat dhe mekanizmat e veprimit për hetimin e rasteve të trafikimit, si dhe për aspekte të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit.
- Një trajnim i përbashkët u organizua në datat 10-11 shkurt 2014, në Tiranë nga TAIEX në koordinim me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik mbi hetimin e trafikimit të fëmijëve dhe forcimin e mbrojtjes së fëmijëve. 40 pjesëmarrës nga Policia, organizatat e shoqërisë civile, Koalicioni Kombëtar i Strehëzave, etj. morën pjesë në këtë trajnim, ekspertët erdhën nga Franca, Italia, Spanja dhe Rumania.
- Ndërsa më datat 11-13 mars 2014, Departamenti Amerikan i Drejtësisë dhe OPDAT, organizuan në Tiranë një workshop mbi trafikimin e personave, ku morën pjesë dhe u trajnuan stafi i NJAT dhe prokurorë të krimeve të rënda, oficerë të policisë gjyqësore dhe specialistë të sektorit kundër trafikëve në DPPSH, si dhe përfaqësues të qendrave mbrojtëse dhe riintegruese. Disa prej tematikave të trajtuara ishin hetimi penal dhe financiar i rasteve të trafikimit, sekuestrimi dhe konfiskimi i aseteve kriminale, identifikimi i viktimave dhe asistencë ndaj tyre, si dhe kompensimi.

Adresimi i punës së detyruar dhe trafikimit të brendshëm:

- Gjatë vitit 2013 pati një ngritje të fokusit të organeve shtetërore tek puna e detyruar dhe trafikimi i brendshëm. Së bashku me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, ZKKA ka zbatuar një projekt të lidhur me shfrytëzimin e punës në Shqipëri, i cili u fokusua në rritjen e kapaciteteve të inspektorëve të punës nëpërmjet trajnimeve të ndërtuara enkas për to dhe promovimit të përgjegjësisë sociale të kompanive.
- Së fundmi Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa për monitorimin e aktiviteteve të tregut të punës dhe bizneseve. Inspektorati të Punës është një nga strukturat kryesore zbatuese të PSV-ve. Në 12 Nëntor, 2013, Koordinatorja Kombëtare pati një takim me përfaqësues të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë për zhvillimin e planeve të përbashkëta të punës për ndërhyrje. Plani i punës u miratua nga palët e lartpërmendura dhe nga Drejtoria e Tatimeve në Ministrinë e Financave nën mbështetjen e Koordinatorës Kombëtare më 19.11.2013. Parandalimi i trafikimit synohet të arrihet me anë të veprimeve kundër paligjshmërisë dhe informalitetit dhe identifikimit në kohë të situatave të mundshme të shfrytëzimit. Një zhvillim i rëndësishëm në vitin 2013 është edhe ngritja e tre Njësive Lëvizëse (Tiranë, Vlorë dhe Elbasan), të ngritura në kuadër të projektit *“Strengthening Albania’s efforts towards an effective and*

sustainable response to trafficking in persons (TIP)” i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit-Zyra J/TIP dhe i zbatuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në partneritet me Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (KKSAT). Njësia Antitrafik ka qenë një promotor i fuqishëm dhe mbështetës i kësaj iniciative dhe *aktualisht po punon për mbështetjen e vazhdimësisë dhe zgjerimit të këtyre 3 NJL*. Në Nëntor 2013, bashkëpunimi me policinë është rritur me nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Drejtorive të Policeve në Qarqe (Tiranë, Elbasan, Vlorë) dhe Njësive Lëvizëse të lartpërmendura. Njësitë Lëvizëse kanë identifikuar 38 viktima të mundshme të trafikimit dhe 11 në vitin 2014. Së bashku me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Koordinatori Kombëtar Antitrafik kanë hartuar një plan veprimi mbi fenomenin e fëmijëve në situatë rruge. Ky dokument përmban veprime të qarta dhe konkrete dhe afate dhe do të formalizohet me një Marrëveshje Mirëkuptimi mes aktorëve të përfshirë.

- Në 19 mars, 2014 Koordinatori Kombëtar organizoi një takim me Policinë e Shtetit dhe Prokurorinë për Krimet e Rënda mbi çështjet që lidhen me identifikimin dhe ndjekjen penale për rastet e trafikimit të personave.

Mbrojtja dhe Asistenca e VT/VMT

Numri total i Viktimave të Trafikimit (VT)/Viktimave të Mundshme të Trafikimit (VMT) për vitin 2013 është 95, prej të cilëve 52 janë madhorë dhe 43 janë të mitur. 81 VT/VMT janë femra dhe 14 janë meshkuj. Gjatë vitit 2013, ka pasur vetëm 3 VT/VMT të huaja. Aktualisht, masat e mbrojtjes së veçantë (mbrojtje e dëshmitarit) janë zbatuar për 1 VT (femër).

a. Strehëzat në Shqipëri:

Ka katër strehëza për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit në Shqipëri. Të gjitha japin shërbime për viktimat e mundshme të trafikimit, viktimat e trafikimit, të huaja ose vendase, fëmijë ose të rritur, meshkuj ose femra: Qendra Pritëse për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) në Tiranë; Të ndryshëm & të Barabartë në Tiranë; Tjetër Vizion në Elbasan; Vatra në Vlorë.

b. Mbështetja për VT/VMT dhe strehëzat:

Për periudhën janar-dhjetor 2013, 30 viktima trafikimi kanë përfituar ndihmë ekonomike me një fond prej 1.080.000 lekë.

2014: Në programin e Mbrojtjes në projekt-buxhetin afatmesëm 2013-2014, për produktin trafikimi i personave është projektuar një fond prej 22.535.000 lekë. Ky fond (ushqim) për operatorët jo publik (Tjetër Vizion, Të Ndryshëm dhe Të Barabartë dhe Vatra) është 2 757 200 lek. Fondi për paketat e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 780 000 lekë. Krahasimisht me vitin 2013, në vitin 2014 për QKPVT janë

planifikuar një milion lekë më shumë, dhe një fond për Ndihën Ekonomike në masën 240000 lekë më shumë se në vitin 2013.

Rritja e partneriteteve me shoqërinë civile

Bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile duke patur për qëllim krijimin e një Grupi Këshillimor të organizatave të shoqërisë civile që merren me çështjet e trafikimit është një tjetër hap drejt rritjes së bashkëpunimit në nivel kombëtar. Në takimin e parë të mbajtur më 15 Nëntor, 2013 kjo iniciativë u mirëprit nga të gjitha organizatat pjesëmarrëse. Mbledhja e radhës u mbajt në 23 dhjetor, 2013. Koordinatorja Kombëtare ka intensifikuar përpjekjet për të zhvilluar një partnership të fortë me shoqërinë civile. Në datat 15 nëntor dhe 23 dhjetor 2013 Koordinatorja Kombëtare mbajti takime me anëtarë të shoqërisë civile për të diskutuar rrugë të mundshme të bashkëpunimit me anëtarë të shoqërisë civile. Kjo iniciativë ka për qëllim të krijojë një bashkëpunim të formalizuar në formën e një Grupi Këshillimor të organizatave antitrafik të shoqërisë civile. Disa OJF i janë përgjigjur kërkesës së KK për dërgimin e Formularëve të shprehjes së interesit për pjesëmarrje në bord. Shumë shpejt, KK do të organizojë një takim dhe do të formalizojë plotësisht Grupin Këshillimor, i cili do të kryejë vlerësime të pavarura dhe do t'i japë ZKKA-së rekomandime.

Fushata ndërgjegjësimi:

- Në kuadër të Ditës Evropiane kundër Trafikimit të Personave- më 19 tetor 2013, u organizua konferenca “Stop Trafikimit! Së bashku mund të bëjmë më shumë!” me pjesëmarrjen e zyrtarëve më të lartë në vend. Në konferencë u artikulua shumë qartë zotimi serioz i përpjekjeve kundër trafikimit në nivel kombëtar, duke mbështetur iniciativat e secilit aktor në kuadër të axhendës së vendosur të prioritetëve.
- ZKKA, ONAC, në bashkëpunim me strehëzën Vatra, ka prodhuar 3 materiale: broshura, fletëpalosje dhe poster me moton “Pyet dhe informohu”, që shërbejnë për rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e trafikimit të personave. Ato targetojnë dy grupe të veçanta:
 - a) Oficerët e policisë dhe format se si ato të kryejnë detyrat e tyre ndaj viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit;
 - b) Viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit se si të njohin dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.
- ZKKA, në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën “Të ndryshëm & të barabartë”, kanë organizuar aktivitete të rritjes së ndërgjegjësimit në kuadër të projektit “Respekt për të drejtat e viktimave në Shqipëri-Fund stigmës” projekt i ndjekur në periudhën 2012-2013. Pjesë kryesore e këtyre aktiviteteve është fotonovela “Kjo është historia ime”, një histori e vërtetë e një viktime trafikimi, e publikuar në 1000 kopje, me qëllim ndërgjegjësimin mbi trafikimin e personave dhe stigmën e cila i shoqëron viktimat: workshop me gjimnazistë - Lezhë në 6 shkurt 2013, 13 shkurt 2013, 20 shkurt 2013; forume me komunitetin - Durrës në 10 prill, 18 prill, 24 prill 2013; forume me komunitetin - Berat në 8 maj, 15 maj, 22

maj 2013 ; forume me komunitetin – Lezhë në 4 mars, 11 mars, 18 maj 2013; workshop me punëdhënës - Durrës në 17 prill 2013, workshop me punëdhënës – Lezhë në 12 qershor 2013. Në 19 Nëntor, 2013 në qarkun Lezë, një mbledhje e organizuar me zyrtarë të zyrave të punës, punëdhënës dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

- Në 2 dhjetor 2013, Koordinator i Kombëtar Antitrafik organizoi një takim me studentë dhe pedagogë të Fakultet të Shkencave Sociale mbi respektimin e të drejtave të viktimave të trafikimit me sloganin “Le të ndalojmë stigmën!” Kjo ishte një mbledhje e organizuar në formatin e një forumi dhe shërbeu për dhënien e mesazheve ndërgjegjësuere për viktimat, si dhe ngritjes së urave bashkëpunuese për luftën kundër trafikimit të personave mes aktorëve shtetërorë dhe administratorëve socialë dhe punonjësve socialë të së ardhmes për një veprim të përbashkët në ndihmë të viktimave të trafikimit. Një takim i njëjtë informues u mbajt në Fakultetin e Drejtësisë në prill 2013.

Përfshirje më e fortë e komunitetit në identifikim dhe raportimin e rasteve të trafikimit- duke përdorur teknologjinë për të rritur identifikimin;

- Nga aktiviteti i Komiteteve Rajonale Antitrafikim:
 - ✓ Në dhjetor janë mbajtur takime me Komitetin Rajonal të Gjirokastrës, Shkodrës, Lezhës dhe Tiranës.
 - ✓ Në datë 31 janar ZKKA me qendrën “Vatra” organizoi trajnimin e Komitetit Rajonal Antitrafik të Shkodrës.
 - ✓ Në datë 25 shkurt, 2014 u mbajt takimi i Komitetit Rajonal Antitrafik të Shkodrës. KK dhe Drejtori i Njësisë Antitrafik morën pjesë në këtë takim dhe mbajtën një prezantim mbi PSV-të për Identifikimin dhe Referimin e VT/VMT si dhe udhëzuan anëtarët e Komitetit për rolin dhe detyrat e Komitetit.
 - ✓ Në datë 27 shkurt, u mbajt takimi i Komitetit Rajonal Antitrafik të Durrësit. ZKKA ishte e pranishme në këtë takim dhe mbajti një prezantim për PSV-të për Identifikimin dhe Referimin e VT/VMT.
 - ✓ Në datë 20 Mars, KK mori pjesë në takimin e KRAT Dibër.
- Në 19 tetor 2013, Ministria e Punëve të Brendshme, Fondacioni Vodafone Albania dhe World Vision nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për lançimin e projektit “Adresimi i Trafikimit të Personave nëpërmjet Teknologjisë Celulare”. Nëpërmjet këtij projekti një Aplikacion i instaluar në telefonat smartfona “Raporto dhe Shpëto!” do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi çështjen e trafikimit të personave, forcimin e partneriteti me komunitetin në lidhje me parandalimin dhe goditjen e trafikimit të personave, rritjen e numrit të identifikimeve fillestare të viktimave të mundshme të trafikimit, si dhe aksesin e shpejtë tek asistencë dhe informacioni. Në datë 7 mars 2014, u mbajt takimi i parë me përdoruesit pilot të APP “Raporto dhe Shpëto/Report and Save”. AKEP-i ka vënë në dispozicion për publikun numrin falas 116-006 për të raportuar raste të trafikimit nëpërmjet thirrjeve dhe sms-ve. Aktualisht, po vazhdon faza e pilotimit të APP “Raporto! Shpëto!”. Ministria e Punëve të Brendshme ka vënë në funksionim linjën telefonike falas 116006. Ky numër është pjesë e një shërbimi

social të harmonizuar të Komisionit European, i cili është në dispozicion të abonentëve dhe përdoruesve pa pagesë.

- Qeveria shqiptare synon ta bëjë publikun më proaktiv në identifikimin dhe raportimin e situatave potenciale të trafikimit të personave nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese dhe përfshirjes më të madhe të komunitetit në identifikimin dhe raportimin e rasteve të trafikimit. Për herë të parë në vitin 2014, NJAT do të ketë buxhetin e saj në shumën e 4.7 milion lekëve. Shumica e aktiviteteve të parashikuara në buxhet do të fokusohen tek parandalimi.

Parandalimi i drogës, zvogëlimi i kërkesës dhe ofertës

Burimet njerëzore, trajnimet dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional:

Gjatë vitit 2013, janë zhvilluar 28 trajnime për njesitë antidrogë dhe njesitë e tjera të zbatimit të ligjit ku janë trajnuar gjithsej 217 punonjës nga të cilët 215 oficerë të Policisë së Shtetit (157 oficerë të njësive antidrogë, 46 policia e rendit, 9 OPGj pranë prokurorisë, 2 policia kufitare, 1 operacionet speciale) dhe 2 oficerë të doganave. Ndërsa, gjatë 3 muajve të parë 2014, janë zhvilluar 3 trajnime ku janë trajnuar 50 oficerë policie nga të cilët 27 nga Seksionet për Narkotikët dhe 23 nga Komisariatet e Policisë.

Disa nga trajnimet më kryesore të zhvilluara gjatë vitit 2013, përmendim:

- Teknikat speciale të hetimit dhe veprimet simuluese me drogat;
- Përdorimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit MEMEX;
- Për kontrollin e kontejnerëve (6 trajnime brenda dhe jashtë vendit)
- Hetimi asteve kriminale (TIAEX)
- Hetimi i veprave penale në fushën e drogës;
- Trajnim bazë dhe i avancuar për hetimet e drogës (DEA dhe ICITAP).

Vlen të përmendet fakti se për vitin 2013 është zbatuar edhe një plan veprimi i përbashkët trajnimi me Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë vitit 2013, në kuadër të një projekti të UNODC dhe Qeverisë Shqiptare e mbështetur nga donatorë të huaj, është ngritur njësia e përbashkët për kontrollin e kontejnerëve në Portin e Durrësit (2 specialistë nga Seksioni Antidrogë, 2 nga Policia Kufitare dhe 2 nga Dogana). Aktualisht po punohet për miratimin e procedurave standarte të punës së kësaj njësie të përbashkët.

Bashkëpunimi me EMCDDA, EUROPOL, SELEC, UNODC dhe inisiativa të tjera:

Gjatë vitit 2013 ka vazhduar bashkëpunimi me EMCDDA (Qendra e Monitorimit të Drogave dhe Varësisë nga Drogat). Ky bashkëpunim ka konsistuar në hartimin e raportit të dytë kombëtar bazuar në standartet e EMCDDA-së dhe mbështetur nga IPA si dhe të Raporteve vjetore mbi situatën e drogës të cilat janë të botura në faqen e EMCDDA-së, në linkun: <http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overviews/al>.

Me datat 2-3 prill 2014, në Mal të Zi, një oficer i sektorit për narkotiket dhe një prokuror morën pjesë në Takimin Rajonal të Reitox-Academy organizuar nga EMCDDA, me temë veprat penale në fushën e drogës.

Në muajin dhjetor është nënshkruar marrëveshja operationale me EUROPOL. Në këtë kuadër, me datat 3 dhe 4 shkurt 2014, u organizua një seminar mbi bashkëpunimin me EUROPOL ku morën pjesë 3 specialistë nga sektori për narkotikët. Gjatë kësaj kohe është intensifikuar shkëmbimi i informacioneve për veprimtari kriminale në fushën e drogës. Gjithashtu, një ekspert i EUROPOL i thirrur nga PAMECA IV, ka bërë një vlerësim të situatës së bashkëpunimit me EUROPOL duke dhënë edhe disa rekomandime për përmirësimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Gjatë vitit 2013 dhe 2014, ka vazhduar bashkëpunimi intensiv me SELEC. Është marrë pjesë në takimet e task-force për drogën dhe janë plotësuar pyetësorët për kapjet e drogave për vitin 2013. Është marrë pjesë në disa takime të organizuara nga SELEC lidhur me operacione të përbashkëta për luftën kundër drogës, si dhe në insitativa të tjera rajonale si “DRUG POLICING BALKAN 2013-2014”.

Analizimi i informacioneve dhe intensifikimi i punës për goditjen e rrjeteve të trafikut e shpërndarjes së drogave, në bashkëpunim me prokurorinë dhe partnerët ndërkombëtarë;

Gjatë vitit 2013 në përgjithësi të gjithë treguesit për luftën kundër drogës kanë patur qëndrueshmëri krahasuar me një vit më parë. Trafiku i marijuanës ka qënë problemi me kryesor gjatë këtij viti, ku ka patur një rritje të numrit të rasteve. Vendet kryesore të destinacionit kanë qënë Greqia, Italia si dhe vende të tjera të rajonit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi etj., të cilat në disa raste përdoren si vende tranzit për destinacione të tjera në vendet e Evropës Perendimore. Po kështu, vihet re një rritje e lehtë e rasteve të kokainës dhe heroinës.

Konkretisht, gjatë vitit 2013, janë evidentuar të dhënat statistikore të mëposhtme:

Lloji	Nr. Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj. Lirë	Kërkim
Heroinë	95	95	47 kg 325 gr	113	102	9	2
Metadon	2	2	137.7 gr	2	1	1	0
Fenterminë	1	1	1.2 gr	1	0	1	0
Kokainë	42	41	16 kg 104.6 gr	59	49	10	0
Marijuanë	949	888	20672 kg 916.9 gr	1137	634	455	48
Hashish	6	6	32 kg 440.2 gr	9	8	0	1
Vaj Hashishi	1	1	359 ml	1	1	0	0
Fara Kanabis	6	6	700 gr	6	5	1	0
Fara Papaver	1	1	5 kg 288.9 gr	1	1	0	0
Përzierës	2	2	1 kg 742.8 gr	2	2	0	0
Totali	1105	1043		1331	803	477	51

Gjatë vitit 2012 janë evidentuar këto të dhëna statistikore:

Lloji	Nr. Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj. Lirë	Kërkim
Heroinë	90	90	87 kg 719.9 gr	120	107	13	0
Metadon	1	1	543.1 gr	2	2	0	0
Kokainë	40	39	4 kg 61 gr	57	48	6	3
Marijuanë	822	777	21138 kg 231.4 gr	1053	663	342	48
Hashish	1	1	5 kg 112.2 gr	3	1	2	0
Vaj Hashishi	0	0	500 gr	0	0	0	0
Fara Kanabis	3	3	343.2 gr	3	1	2	0
Përzierës	5	5	174 kg 967.1 gr	7	7	0	0
Totali	962	916		1245	829	365	51

Krahasuar me vitin 2012, është rritur me 14.8% numri i rasteve të kapjeve të lëndëve narkotike dhe është rritur me 6.9% numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogës që janë proceduar penalisht; (Më poshtë paraqitja grafike). Nga numri total i personave të proceduar penalisht për shitje e trafikim të lëndëve narkotike (1331), 1292 janë shtetas shqiptarë dhe 39 shtetas të huaj, 11 nga Italia, 8 nga Kosova, 6 nga FYRoM, 5 nga Greqia, 3 nga Mali i Zi, 2 nga Polonia, 1 nga Gjermania, 1 nga Austria, 1 nga Turqia, 1 nga Kroacia. (Në vitin 2012 ishin 38 autorë të proceduar penalisht, shtetas të huaj).

Përsa i përket sasive të lëndëve narkotike të sekuestruara, është vënë re një rritje e sasisë: Kokainë (+296.5 %) dhe ulje të sasisë Heroinë (-46 %) dhe Marijuanë (-2.2%).

Lloji lëndës	Viti 2012	Viti 2013	%
Heroinë	87 kg 719.9 gr	47 kg 325 gr	-46
Kokainë	4 kg 61 gr	16 kg 104.6 gr	+296.5
Marijuanë	21138 kg 231.4 gr	20672 kg 916.9 gr	-2.2

Gjatë vitit 2013:

- Janë goditur 43 grupe kriminale të trafikut dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike me 196 persona të proceduar penalisht. (Në vitin 2012 janë goditur 50 grupe kriminale me 233 persona të proceduar penalisht)
- Jane realizuar 50 operacione duke zbatuar teknikat speciale të hetimit. (Gjatë vitit 2012 janë realizuar 50 operacione të tilla).

Jane realizuar me sukses 54 operacione duke përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar (43 me Italinë, 5 me Gjermaninë, 2 me Greqinë, 1 me Kosovën, 1 me Francën, 1 me Belgjikën, 1 me Çekinë) ku në Shqipëri janë arrestuar 77 persona. Operacionet me të spikatura janë: **Operacioni "Underground-AL"** në bashkëpunim me autoritetet Italiane, ku u sekuestruan rreth 1 ton marijuanë si dhe u arrestuan 4 persona në Shqipëri dhe 7 në Itali; Operacioni **"Sotto Traccia -AL"** i koordinuar nga Eurojust dhe i zhvilluar njëkohësisht në Itali, Shqipëri, Francë, Hollandë, Belgjikë dhe Zvicër, ku u arrestuan në Shqipëri 10 persona dhe 14 të tjerë në vendet e sipërpërmendura, pjesarë të një organizate kriminale të trafikut ndërkombëtar

të drogës; **Operacioni “Paquettes 2010”** në bashkëpunim me autoritetet Italiane ku u arrestuan në vendin tonë 2 persona për trafikim të sasirave të konsiderueshme të lëndëve narkotike në drejtim të Italisë; **Operacioni “Tranzit”** zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet e Kosovës, Italisë dhe Zvicrës kundër një grupi kriminal të trafikut të marijuanës në linjën Kosovë-Shqipëri-Itali-Zvicër, i cili solli sekuestrimin e 100 kg marijuanë dhe arrestimin e 6 personave; **Operacionet “Ellenika-AL” dhe “Ellenika 2”**, zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet italiane ku janë sekuestruar sasi të konsiderueshme lënde narkotike dhe deri tani në vendin tonë janë arrestuar 6 persona. **Operacioni “Trust-AL”** zhvilluar në bashkëpunim me autoritetet italiane, ku u sekuestruan 106 kg marijuanë dhe u arrestuan 3 persona në vendin tonë. (Gjatë vitit 2012 janë realizuar 54 operacione ndërkombëtare me 76 persona të proceduar penalisht në vendin tonë).

Treguesit kundër narkotikëve për periudhën 3 mujori I-rë 2014.

Tabela statistikore për veprat penale dhe autorët e proceduar penalisht, si dhe sasi të drogave të sekuestruara për periudhën – 3 mujori I-re 2014.

Lloji	Nr.Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj.Lirë	Kërkim
Heroinë	21	21	16 kg 972.5 gr	29	28	0	1
Kokainë	22	21	2 kg 669.6 gr	23	23	0	0
Marijuanë	284	269	11083 kg 766.7 gr	341	203	124	14
Hashish	0	0	2 kg	0	0	0	0
Fara Kanabis	1	1	6 gr	2	2	0	0
Totali	328	312		395	256	124	15

Tabela statistikore për veprat penale dhe autorët e proceduar penalisht, si dhe sasi të drogave të sekuestruara për periudhën – 3 mujori I-re 2013

Lloji	Nr.Raste	Zbuluar	Sasia	Autorë	Arr/Ndal	Gj.Lirë	Kërkim
Heroinë	27	27	17 kg 91.9 gr	34	32	2	0
Fenterminë	1	1	1.2 gr	1	0	1	0
Kokainë	8	8	1 kg 710.7 gr	8	8	0	0
Marijuanë	250	238	5676 kg 738.8 gr	316	191	111	14
Hashish	1	1	431.6 gr	2	2	0	0
Fara Kanabis	1	1	3.1 gr	1	1	0	0
Fara Papaver	1	1	288.9 gr	1	1	0	0
Perzieres	0	0	1 kg 658.7	0	0	0	0
Totali	289	277		363	235	114	14

Gjatë 3 mujorit të parë 2014, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, është rritur me 13.5% numri i rasteve të kapjeve të lëndëve narkotike; është rritur me 8.9% numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogës që janë proceduar penalisht dhe është rritur me 7.2% numri i autorëve të arrestuar.

Përsa i përket sasive të lëndëve narkotike të sekuestruara, është vënë re një rritje e sasisë: Kokainë (+56 %), Marijuanë (+95.2 %) dhe ulje të sasisë Heroinë (-0.7%).

Gjatë periudhës **3 mujori I-rë 2014:**

- Janë kryer 15 operacione ku janë përdorur Teknikat Speciale Hetimore;

(14 janë kryer në të njëjtën periudhë të vitit 2013)

- Janë goditur 15 grupe kriminale të trafikut e shpërndarjes së lëndëve narkotike me 66 persona të proceduar penalisht.

(14 grupe me 65 persona janë goditur në të njëjtën periudhë të vitit 2013)

- Janë kryer 21 operacione ku janë përdorur forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar ku janë arrestuar 25 persona për trafik ndërkombëtar droge (16 me Italinë, 3 me Greqinë, 1 me SHBA-në, 1 me Kosovën).

(12 operacione ndërkombëtare me 21 persona të arrestuar janë kryer në të njëjtën periudhë të vitit 2013).

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike:

Për vitin 2013, është hartuar dhe zbatuar Plani i Veprimit Kombëtar nr. 40/1, datë 07.03.2013, "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike gjatë vitit 2013" miratuar nga Ministri i Brendshëm si dhe Plani Operacional nr. 416, datë 18.03.2013 "Për kontrollin, monitorimin evidentimin dhe asgjësimin e parcelave të mbjella me bimë narkotike Cannabis Sativa" miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Janë hartuar edhe zbatuar disa plane monitorimi me helikopter dhe me avion nga Guardia di Finanza në kuadër të një marrëveshjeje bashkëpunimi.

Në shkallë vendi janë angazhuar në operacione policore gjithsej 2124 forca policore dhe 271 mjete policie të Drejtorive të Policisë në Qarqe, të Komisariateve të Policisë së Forcave të Ndërhijres së Shpejtë, Shkodër, Tiranë e Fier, një avion i njësisë speciale të aviacionit italian të Guardia di Finanza me bazë në Napoli, dy helikopterë të Komisarariatit Special "RENEA" si dhe dy helikopterë së bashku me autobotin e furnizimit të Forcave Ajrore të Ushtrisë.

Janë kryer 44 misione fluturuese nga ajri nga këto:

- 19 misione fluturimi me helikopter të policisë së shtetit
- 25 misione fluturimi me avionë të Guardia di Finanza dhe është monitoruar një territor prej 3618 km².

Për vitin 2013 në të gjithë territorin e vendit janë evidentua 229 vepra penale të kultivimit të bimëve narkotike me 98491 bime të asgjësuar, për të cilat janë përgatitur 229 referime për në prokurori, janë zbuluar 77 raste, me 89 autorë, janë arrestuar në flagrancë 52 autorë, ndiqen në gjendje të lirë 16 autorë dhe janë shpallur në kërkim 21 autorë.

Rastet e evidentimit të kultivimit të bimëve narkotike janë si më poshtë :

Qarku	Nr. rasteve	Zbuluar	%	Nr.Bimëve	Autorë	Arr/nd	Gj. Lirë	Kërkim
Berat	6	5	100	511	7	1	2	4
Dibër	6	4	60	830	5	4		1
Durrës	37	13	31	13277	15	4	3	8
Elbasan	5	4	40	295	2	2		
Fier	17	15	94	3705	17	10	5	2

Gjirok	8	1	12	1197	1			1
Korçë	4	4	100	421	4	4		
Kukës	7	1	14	5541	1	1		
Lezhë	8	3	28	2995	6	6		
Shkodër	54	17	34.5	51250	19	15	2	2
Tiranë	10	7	100	5642	11	5	3	3
Vlorë	67	3	60	12827	1		1	
SHUMA	229	77	36	98.491	89	52	16	21

Për vitin 2014

Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike nga Policia e Shtetit deri në datë 09.04.2014, janë kryer këto detyra:

Masa përgatitore/parandaluese.

- Është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Plan i Veprimit Nr. 301, datë 06.03.2014, "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimeve narkotike gjatë vitit 2014".
- Është miratuar grafiku i takimeve sensibilizues në zbatim të detyrave të parashikuara në Plan-Veprimin nr. 301, datë 06.03.2014.
- Janë ngritur grupet e drejtimit në nivel qendror në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në nivel lokal në të gjitha drejtoritë e policisë qarqeve.
- Janë miratuar planet e masave të Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe komisariateve të policisë "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike gjatë vitit 2014".
- Janë zhvilluar 12 takime rajonale në të gjitha qarqet.

Gjithashtu nga drejtoritë e policisë së qarqeve dhe komisaritet e policisë në bashkëpunim me drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore dhe drejtorive arsimore në qarqe, në funksion të parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike, janë zhvilluar gjithsej 98 aktivitete të ndryshme sensibilizuese, si dhe janë zhvilluar programe mësimore në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme me temë, "Karakteristikat e bimëve narkotike dhe efektet negative të tyre" me përfitues gjithsej 3460 nxënës.

Janë zbatuar këto masa operationale:

Në kuadër të masave për zbatimin e detyrave të Planit të Veprimit, nga strukturat e Policisë së Shtetit janë identifikuar 3 raste me bimë narkotike të përgatitura në gota plastike (kubikë) për tu kultivuar dhe 2 raste me bimë narkotike të sapo mbjella në tokë, gjithsej 5 raste dhe 1348 bimë narkotike cannabis sativa, si dhe janë arrestuar në flagrancë 5 autorë.

Strukturat e Policisë së Shtetit në nivel qendror dhe vendor do të vijojnë punën për të përmbushur me sukses të gjithë detyrat e parashikuara në Planin e Veprimit "Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike", duke bashkëpunuar edhe me organet e qeverisjes vendore, si dhe me të gjithë institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Politikat e anti-diskriminimit

Për sa i përket politikave të anti-diskriminimit, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), masat e marra në dhjetor të vitit 2011 e në janar të vitit 2012, të cilat kishin të bënin me rregullime të karakterit normativ, si hartimi i aktit nënligjor, Urdhëri Nr.7, datë 10.01.2012 Ministrit të Brendshëm dhe rregullimi i formatit “Asistencës në lindje”, dhanë rezultate konkrete. Këto masa kishin si qëllim:

- 1) Parandalimin e krijimit të rasteve të reja për fëmijë të lindur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të mbetur të paregjistruar;
- 2) Evidentimin e rasteve të prapambetura, grupimi i tyre sipas tipologjisë, për të përcaktuar më pas zgjidhjen e tyre.

Si pasojë, gjatë vitit 2013 nuk kemi të evidentuar të lindur të cilët kanë mbetur pa u regjistruar për shkaqet e mëparshme, si psh. plotësimi i “Asistencë në lindje” me të dhëna jo reale të nënës.

Gjithashtu, theksojmë se janë regjistruar gjatë vitit 2013, si raste të evidentuara të prapambetura, 123 fëmijë vetëm nga komuniteti Rom, ndërsa për periudhën katër mujore 01.01.2014, e deri sot, janë regjistruar rreth 60 fëmijë nga komuniteti Rom, si “regjistrime të vonuara”.

Për specifikën që ka ky proces, theksojmë se nuk mund të krahasojmë periudhat me njëra tjetrën, pasi qëllimi është që kjo shifër e evidentuar apo dhe ato që mund të dalin në të ardhmen të reduktohen në shifrat minimale, deri në zhdukjen e këtij fenomeni.

Këto raste të evidentuara dhe të zgjidhura, janë kryer nëpërmjet dy rrugëve:

- a) 90% me rrugë administrative
- b) 10% me rrugë gjyqësore.

Në analizë të tipologjisë këto raste i ndajmë:

- Lindur jashtë shtetit;
- Lindur jashtë mjediseve të shëndetësisë/maternitetit dhe për pasojë nuk janë pajisur me dokumentin “asistencë në lindje”;
- Lindur në mjediset shëndetësore/maternitete dhe nëna ka paraqitur të dhënat e saj të gabuara;
- Lindur në maternitet dhe braktisur te të afërmit, të cilët janë regjistruar si fëmijë të gjetur;

Kështu gjatë vitit 2013, të gjitha rastet e fëmijëve të paregjistruar të konstatuara nga ana e shërbimit të gjendjes civile, u grupuan sipas problematikës që ato mbartnin me qëllim gjetjen e mekanizmit të zgjidhjes së secilit prej tyre.

Ajo që kemi nevojë sot është procesi i identifikimit të rasteve të fëmijëve të lindur dhe të paregjistruar, për arsyet e specifikuara edhe më parë.

Ky moment, kërkon së pari, ndërgjegjësimin e vetë komunitetit Rom dhe së dyti të gjitha autoritetet shtetërore, të cilat mund të identifikojnë raste të tilla, të mund ti denoncojnë ato pranë institucioneve që kanë detyrimin për regjistrim, duke filluar, që nga zyra e gjendjes civile, përfaqësuesit e pushtetit lokal, organet e policisë së shtetit etj.

Veç institucioneve administrative publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ka bashkëpunuar dhe me institucione jo publike, si OJF, të cilat mbulojnë fushat për liritë dhe të drejtat e njeriut, e vecanërisht të fëmijëve, si dhe me shoqata të komunitetit Rom.

Parimisht është rënë dakord që shoqatat e komunitetit Rom, të cilat bashkëpunojnë apo financohen nga UNICEF, IOM etj. do të bëjnë sensibilizimin e komunitetit që ato përfaqësojnë për të bërë të mundur identifikimin e rasteve të fëmijëve të paregjistruar nga ky komunitet. Pasi të kenë përfunduar këtë lloj identifikimi, specialist nga DPGJC dhe përfaqësues nga shoqatat do të lëvizin në terren duke analizuar dhe dhënë zgjidhjen për secilin rast të konstatuar.

Ky proces afatshkurtër do të sjellë:

1. Identifikimin e rasteve, gjë e cila do të shprehë dhe masën e vërtetë të fenomenit.
2. Zgjidhjen e rasteve që janë të mundur nga pikpamja administrative.
3. Adresimin e rasteve të tjera në rrugë gjyqësore, duke përcaktuar dhe objektin.

Masa e re afatmesme që pritet të marrë miratim në formë administrative, është dhe ngritja e rrjeti komunikimi midis Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Ky projekt parashikon që institucionet e shëndetit publik që kanë detyrimin të vërtetojnë lindjen, të bëjnë njoftimin e lindjes nëpërmjet komunikimit elektronik me shërbimin e gjendjes civile.

Të drejtat themelore, përfshirë mbrojtjen e të dhënave.

Sistemi i burgjeve, parandalimi i torturave dhe keqtrajtimit.

Për garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar në ambientet e policisë, si dhe parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit, janë zbatuar këto masa:

- Përmirësimi i kushteve të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit ku mbahen e trajtohen personat e privuar nga liria, nëpërmjet kryerjes së investimeve për rikonstruksionin e tyre.

- Rritja e nivelit tekniko-profesional të personelit policor, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.
- Rritja e transparencës së punës së Policisë së Shtetit, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut.
- Zbatimi i raporteve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Komitetit të Parandalimit të Torturës (CPT) dhe organizatat e shoqërisë civile.

Më konkretisht, nga strukturat e policisë gjatë vitit 2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014, janë planifikuar dhe zbatuar këto masa:

- **Në drejtim të përmirësimit të kushteve të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit ku mbahen e trajtohen personat e privuar nga liria :**
 - Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 kanë përfunduar realizimi i investimeve për rikonstruksionin dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme të personave të shoqëruar dhe ata ta arrestuar/ndaluar në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Tiranë dhe Komisariatit e Policisë Durrës, si dhe ka filluar funksionimi i tyre. Rikonstruksioni dhe krijimi i këtyre ambienteve është bërë me financime të Buxhetit të Shtetit, duke ju përmbajtur kushteve dhe kriterëve ndërkombëtare të ndërtimit dhe funksionimit.
 - Janë instaluar sistemet e monitorimit me kamera të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit në drejtorinë e Policisë të Qarkut Tiranë dhe Komisariatit e Policisë Durrës, të cilat janë vënë në funksionim në të njëjtën kohë me ambientet në fjalë.
 - Është bërë kërkesë për shtim limiti për realizimin e rikonstruksionit të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit për të arrestuarit/ndaluarit dhe shoqëruarit në Komisariatit e Policisë Vlorë, pasi dhe projektet për këtë qëllim janë përgatitur dhe janë të miratuara.
 - Nga ana e drejtorive të policisë së qarqeve me fondet buxhetore të akorduara për vitin 2013 dhe 2014 janë marrë masa për realizimin e ndërhyrjeve me qëllim përmirësimin e kushteve të ambienteve të dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit duke i lyer, vendosur orenditë dhe pajisjet për qëndrimin ulur të personave të shoqëruar, krijimin e kushteve për realizimin e banjave me ujë të ngrohtë, krijimin e kushteve për ngrohje gjatë stinës së dimrit, zëvendësimin e teshave të fjetjes, etj.
- **Rritja e nivelit tekniko profesional të personelit policor nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve për njohjen dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria:**
 - Për çdo vit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, hartohet dhe miratohet Programi Vjetor i Trajnimeve të Policisë së Shtetit, pjesë përbërëse e të cilit janë dhe trajnimet e personelit policor të nivelit zbatues, nivelit të parë dhe të mesëm të drejtimit për njohjen e respektimin e të drejtave të personit të shoqëruar, ndaluar dhe të arrestuar.
 - Më datë 28.02.2013, nga Avokati i Popullit është organizuar një takim me temë: **“Roli i mjekëve, i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Institucioneve të**

Ekzekutimit të Vendimeve Penale për monitorimin dhe menaxhimin e grevave të urisë". Në këtë takim nga Policia e Shtetit morën pjesë rreth 20 punonjës policie, përfaqësues nga Drejtoria e Rendit Publik dhe nga strukturat e Rendit Publik në qarqe.

- Gjatë muajit Dhjetor 2013 rreth 45 punonjës të policisë (përfaqësues të strukturave qendrore dhe të strukturave vendore të rendit) kanë marrë pjesë në seminarët e organizuara nga organizatat e shoqërisë civile si: Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Instituti Evropian i Tiranës dhe Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës. Këto seminare janë zhvilluar një ditore në të cilat është bërë prezantimi i raporteve të vizitave dhe inspektimeve që janë kryer nga OJF-të në drejtoritë dhe komisariatet e policisë si dhe rekomandimet përkatëse.
- Gjatë muajit Dhjetor 2013 (datë 26 dhe 27) në Qendrën e Formimit Policor është zhvilluar trajnim një ditë me dy grupe mësimore me nga 25 punonjës për çdo grup. Në këtë trajnim morën pjesë: shefat e sektorëve të rendit në D.P.Qarqeve, personeli mjekësor dhe ai psikolog të D.P.Qarqeve si dhe përgjegjësit e dhomave të sigurisë të komisariateve të policisë.

Tematika e këtij trajnimi ka qenë: "Garancitë që ofron legjislacioni Shqiptar dhe ai policor për trajtimin shëndetësor dhe psikologjik të ndaluarve/arrestuarve në ambientet e policisë". Ky trajnim është zhvilluar nga Qendra e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës në bashkëpunim me struktura të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

- **Rritja e transparencës së punës së Policisë së Shtetit dhe bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut.**

Për vitin 2013 janë hartuar dhe nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa OJF, si:

- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Institutit Evropian të Tiranës me nr. 1627, datë 25.03.2013 dhe nr. 27, datë 25.03.2013 "Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit".
- Marrëveshja e bashkëpunimit midis Policisë së Shtetit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit me nr. 1626, datë 25.03.2013 dhe nr. 68, datë 26.03.2013 "Për përmirësimin e trajnimit dhe respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit".
- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 106, datë 26.06.2013 dhe nr. 3512, datë 08.07.2013 "Për parandalimin e torturës, keqtrajtimit dhe rritjen e nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që privohen nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit".

Përfaqësuesit e këtyre OJF-ve për vitin 2013 janë pajisur me leje provizore hyrje për të inspektuar e monitoruar ambientet e dhomave të sigurisë dhe ato të shoqërimit për respektimin e të drejtave të këtyre personave si më poshtë:

- 27 punonjës nga të KShH-së.
- 6 punonjës nga "Të drejtat e Njeriut në Demokraci".
- 8 punonjës nga të QSHRT-ja.

- **Njohja dhe zbatimi i raporteve dhe rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, Komiteti i Parandalimit të Torturës (CPT) dhe organizatat e shoqërisë civile:**
 - Raportet dhe rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit, CPT-ja dhe OJF-të u janë bërë të njohura strukturave vendore të policisë. Po kështu u janë përcaktuar dhe detyrat që do të kryejnë për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë.
 - Janë përgatitur një sërë aktesh administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë ku tërhiqet vëmendja personelit policor dhe drejtuesve të njësisë policore në drejtim të përmirësimit të trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar, si:
 - a. Tërheqje vëmendje nr. 7946/1, datë 25.11.2013 “Për parandalimin dhe eliminimin e sjelljeve/qëndrimeve që çënojnë dinjitetin e individit për shkak të etnisë”.
Në këtë tërheqje vëmendje vihet theksi në trajtimin e njëlojtë, pa diskriminim dhe të barabartë të të gjithë shtetasve sipas përcaktimeve të nenit 18 të Kushtetutës, vlerësimin dhe trajtimin e të gjitha ankesave, denoncimeve të bëra për keqtrajtime/abuzime apo shkelje të të drejtave të personave, si dhe marrjen e masave disiplinore dhe kur janë kushtet dhe ato penale ndaj personelit policor përgjegjës.
 - b. Tërheqje vëmendje nr. 9045, datë 31.12.2013 “Për hedhjen e pasqyrimin e të dhënave për personat e shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar në sistemin ADAM”.
 - c. Tërheqje vëmendje nr. 8728, datë 02.12.2013 “Për rishikimin e masave të sigurisë dhe përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar, në ambientet e policisë”.
 - d. Tërheqje vëmendje nr. 1947, datë 12.03.2014 “Për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësisë në përputhje të plotë me aktet ligjore, nënligjore dhe procedurat standarde të punës, duke respektuar e garantuar të drejtat e personave të privuar nga liria”.
 - Në vlerësim të rekomandimeve të bëra nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve Degraduese e Çnjerëzore (CPT) të KE-së dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, janë hequr nga përdorimi/funksionimi ambientet e dhomave të sigurisë të Komisarariatit të Policisë Pogradec, në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Korçë.
Nxjerrja jashtë funksionimi është bërë me urdhrin nr. Nr. 569 datë 17.04.2014 “Për heqjen nga përdorimi/funksionimi të dhomave të sigurisë në Komisariatin e Policisë Pogradec, në Drejtorinë e Policisë të Qarkut Korçë”.

Barazia gjinore

Në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe Planit të Veprimit mbi Diversitetin, Policia e Shtetit ka vijuar të ndërmarrë hapa të rëndësishëm për promovimin dhe realizmin praktik të vlerave të diversitetit e të barazisë gjinore.

Gjatë 2013 janë marrë masat për organizimin dhe realizimin e Procesit të Vetëvlerësimit Gjnor në Policinë e Shtetit, si dhe planifikimin apo pjesëmarrjen në trajnime, tryeza diskutimesh dhe workshop-e të ndryshme, me përfaqësues nga institucione dhe OJF, me të cilat janë vendosur marrëdhënie bashkëpunimi.

Procesi i Vetëvlerësimit Gjnor në Policinë e Shtetit u iniciua në bashkëpunim me Qendrën për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë (DCAF) me mbështetjen logjistike të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjnore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) në Shqipëri me qëllim kryerjen e një vlerësimi gjnor të organizatës nga vetë policia, me objektiv arritjen e barazisë gjnore.

Për realizimin e këtij procesi u ngrit grupi i punës, i cili pas përpunimit të informacionit të mbledhur nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, anketimeve, intervistave dhe grupeve të fokusit, hartoi Raportin e Vetëvlerësimit Gjnor në Policinë e Shtetit.

Në kuadër të realizimit të rekomandimeve të nxjerra nga Raporti i Vetëvlerësimit Gjnor, aktualisht po punohet për hartimin e Planit të Veprimit Gjnor me mekanizma monitorimi dhe vlerësimi si dhe për hartimin e një Politike të Brendshme mbi ngacmimin seksual/mjedisin e sigurt në punë.

Aktualisht në Policinë e Shtetit janë punësuar 10.74% të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, ndërsa punonjëset e Policisë së Shtetit me grada policore përbëjnë 6.57% të të gjithë punonjësve. Numri i punonjësve të Policisë që vijnë nga minoritetet të ndryshme etnike dhe kulturore është 0,45% të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave, gjatë këtij viti kanë nisur procedurat për të rekrutuar 500 punonjëse të reja policie.

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve të punonjësve të Policisë së Shtetit mbi diversitetin dhe barazinë gjnore, janë zhvilluar disa aktivitete:

- Në muajin Janar punonjës të strukturave të ndryshme në Policinë e Shtetit kanë marrë pjesë në trajnimin me temë “Termet thelbësore në lidhje me personat LGBT, përballja me paragjykimin dhe stereotipet kundër komunitetit LGBT”, i organizuar në bashkëpunim me Aleancën Kundër Diskriminimit LGBT.
- Në muajin mars, me mbështetjen e UN Women, u organizua trajnimi me temë “Rritja e aftësive drejtuese të grave në radhët e Policisë së Shtetit”, me pjesëmarrjen e 13 punonjësve të strukturave të ndryshme në të gjitha drejtoritë e policive në qarqe në role menaxhuese.
- Në muajin prill u organizua trajnimi i dytë i këtij lloji me pjesëmarrjen e 16 punonjësve të tjera nga struktura të ndryshme në të gjitha drejtoritë e policive në qarqe, i fokusuar tek tematika e zgjidhjes dhe transformimit të konflikteve.
- Ndërkohë, po në muajin prill, nën kujdesin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit është publikuar “Manuali për Barazinë dhe Diversitetin”, me qëllim që të ndihmojë punonjësin e Policisë së Shtetit që të kuptojë më mirë konceptet e barazisë, diversitetit dhe mosdiskriminimit pavarësisht përkatësisë gjnore, etnisë, racës, orientimit seksual, etj.

- Po ashtu, në bashkëpunim me Programin ICITAP, janë duke u zhvilluar disa takime në lidhje me krijimin e lehtësirave për rekrutimin dhe integrimin e romëve në Policinë e Shtetit, me synim për një përfaqësim më të madh të tyre në Shkollën Bazë të Policisë.
- Është marrë pjesë në disa aktivitete si takimet me delegacione të ndryshme nga OSBE dhe Këshilli i Europës mbi angazhimin e forcave të policisë në drejtim të promovimit të diversitetit dhe kundër diskriminimit në vendin e punës; takime të ndryshme me grupin e punës të ngritur në Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në kuadër të zbatimit të planit të masave të personave për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si dhe takime të ndryshme të organizuar nga Ambasada Pink dhe Aleanca LGBT mbi mbrojtjen nga diskriminimi të personave me orientim seksual ndryshe.

Të drejtat e fëmijëve

Përshtatja e ambienteve të policisë ku intervistohen dhe mbahen të miturit, në mjedise miqësore për të mitur:

Gjatë vitit 2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014 është bërë i mundur ndërtimi/ përshtatja e ambienteve të posaçëm për intervistimin e të miturve në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, Vlorë, Korçë, Fier dhe Shkodër.

Këto ambiente u krijuan në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Tiranë si dhe Organizatës “Save the Children”, me të cilën është nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi Nr.3400/1 Prot, datë 18.06.2012, për “Sigurimin e ambienteve të posaçme për intervistimin e të miturve viktime, dëshmitarë dhe/ose të implikuar në krime, duke u bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim”. Qëllimi i kësaj marrëveshje është implementimi i praktikave më të mira bashkëkohore të intervistimit të të miturve viktime, dëshmitarë të krimeve, si dhe të miturve të implikuar, duke krijuar ambiente të posaçme për intervistimin e tyre, në Drejtoritë të Policisë në Qarqe.

Zhvillimi i trajnimeve në bashkëpunim me Organizatat Ndërkombëtare dhe ato vendase:

- Në kuadër të përgatitjes dhe miratimit më Urdhër të DPPSH Nr.300, datë 08.07.2013 të Procedurave Standarde të Punës për "Trajtimin e të Miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake" me përfaqësues të QSHPLL, dhe Organizatës “Save the Children”, u punua mbi organizimin për këtë qëllim të aktiviteteve trajnuese me struktura vendore të hetimit të krimeve”, në DPQ Tiranë, Dibër, Korçë, Durrës, Shkodër, Lezhë, Kukës dhe Elbasan. (Periudha e zhvillimit të aktiviteteve trajnuese, Tetor-Dhjetor 2013).
- Në kuadër të zhvillimit të një aktiviteti trajnues 5-ditor, me mbështetjen e Programit “ICITAP” dhe “Save The Children”, në Qendrën e Formimit Policor janë zhvilluar temat mësimore:
 - Legjislacioni kundër abuzimit seksual me fëmijët dhe situata e këtij fenomeni në aspektin statistikor;

- Njohuri mbi procedurat standarde që duhen zbatuar në rastet e dhunës seksuale ndaj fëmijëve.
- Në zbatim të Urdhrit nr.1/96, datë 19.02.2013 të Departamentit për Trajnimin Policor, është zhvilluar trajnimi me temë: “Çështjet ligjore dhe politika e Policisë së Shtetit Shqiptar për Dhunën në Familje, me fokus fëmijët”.

Trajnime të kryera nga Departamenti për Sigurinë Publike.

Në zbatim të Urdhrit 1/238, datë 21.02.2014 të Departamentit për Shërbimet Mbështetëse, u zhvillua trajnimi me temë: “Trajtimi i të miturve gjatë fazës së hetimeve paraprake”.